



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA

# Raport Vlerësimi mbi Aplikimin e Drejtësisë Procedurale në Shtatë Gjykatat Themelore të Kosovës

---

Janar 2022







**RAPORT VLERËSIMI MBI  
APLIKIMIN E DREJTËSISË  
PROCEDURALE NË  
SHTATË GJYKATAT  
THEMELORE TË KOSOVËS**

**AUTORE:**

Dr. Albana Rexha



Vizito webfaqen tonë  
[www.dplus.org](http://www.dplus.org)

Mësoni më shumë rreth publikimeve tona të fundit,  
lajmeve dhe infografikave online.



Find us on Facebook  
[@democracyplus](https://www.facebook.com/democracyplus)



Find us on Facebook  
[@democracy-plus](https://www.facebook.com/democracy-plus)



Find us on Twitter  
[@democracy\\_plus](https://twitter.com/democracy_plus)



Find us on Youtube  
[@Democracy Plus](https://www.youtube.com/DemocracyPlus)

**Zyra Jonë:**

Rruga Tirana Blloku C/4/1, Hyrja C,  
Kati VIII, Nr. 83/84  
Prishtinë 10000, Kosovë

+383 (0) 38 749 288  
[info@dplus-ks.org](mailto:info@dplus-ks.org)

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet ose transmetohet në çfarëdo forme ose me ndonjë mjet elektronik, mekanik, fotokopjues ose tjera, pa lejen e D+.

\* Ky raport politikash është shkruar në gjuhën angleze, andaj për çdo paqartësi në këtë version të përkthyer dhe përshtatur, ju lutem konsultohuni me versionin origjinal *Assessment of the Procedural Justice Application Tools Across Seven Basic Courts in Kosovo*.

**Mohim i përgjegjësisë:**

Ky botim u krijua për shqyrtim nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar. Ky dokument u përgatit nga Demokraci Plus dhe pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdo pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.



# Përmbajtja

Të gjeturat kryesore.....	6
Hyrje .....	8
Metodologjia .....	10
Anketa me Përdorues të Shërbimeve të Gjykatave:.....	10
Variablat: .....	11
Qasja në informacion .....	11
Transparenca .....	11
Efikasiteti.....	11
Paanshmëria .....	11
Prevalenca e korrupsionit.....	11
Pyetjet shitesë.....	11
Anketa e Vëzhgimit të Përvojës në Gjykatore .....	12
Të dhënat demografike.....	13
<b>Rezultatet e anketës me përdoruesë të shërbimeve të gjykatave.....</b>	<b>19</b>
Qasja në Informacion dhe Transparenca.....	20
Renditja e përgjithshme e gjykatave rreth Qasjes në Informacion dhe Transparencë.....	28
Efikasiteti dhe paanshmëria .....	29
Renditja e përgjithshme e gjykatave sa i përket efikasitetit dhe paanshmërisë .....	46
Prevalenca e korrupsionit .....	47
Renditja e përgjithshme e gjykatave në raport me prevalencën e korrupsionit.....	51
Pyetje shitesë.....	52
Renditja e përgjithshme e gjykatave përkitazi me pyetjet shitesë .....	69
<b>Krahasimi i renditjes në mes të gjykatave themelore (2018- 2021) .....</b>	<b>71</b>
Krahasimi i renditjes së të gjitha gjykatave në qasjen në informacion dhe transparencë për periudhën 2018-2021.....	73
Krahasimi i renditjes së të gjitha gjykatave rreth efikasitetit dhe paanshmërisë për periudhën 2018-2021 .....	74
Krahasimi i renditjes së të gjitha gjykatave rreth prevalencës së korrupsionit për periudhën 2018-2021.....	75
<b>Rezultatet e anketës të vëzhgimit të përvojës në gjykatore .....</b>	<b>77</b>
Renditja e gjykatave themelore bazuar në rezultatet e pyetjeve të observimit të punës në gjykatë....	99
Rekomandime të politikave.....	101
SHTOJCA A .....	102
SHTOJCA B .....	110

# Të gjeturat kryesore

## Të gjeturat e anketës me përdoruesit e shërbimeve të gjykatave

### Qasja në informacion dhe transparenca:

Rreth **90%** e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave e shohin gjetjen e gjykatoreve dhe zyreve ku kanë nevojë të shkojnë deri diku të lehtë.

Rreth **71%** e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave e shohin gjetjen e informacionit për rastet e tyre si deri diku të lehtë apo të lehtë.

Rreth **79%** të përdoruesve të shërbimeve të gjykatave nuk e përdorin ueb-faqen e gjykatës për të marrë informacione

Rreth **53%** e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave nuk e dinë se ekziston kutia e ankesave në gjykatë, ndërsa **3%** deklarojnë që nuk ka ndonjë kuti të ankesave.

### Efikasiteti dhe paanshmëria:

Rreth **77%** e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave deklarojnë që janë trajtuar me mirësjellje dhe respekt nga ana e stafit të gjykatave. Ndarja e të dhënave sipas gjinisë reflekton të njëjtën ndjenjë edhe në mesin e grave e edhe të burrave.

Rreth **94%** e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave kishin mundësinë të flasin në gjuhën e tyre amtare dhe rreth **89%** e tyre kanë pranuar dokumente në gjuhën e tyre amtare.

Rreth **98%** të përdoruesve të shërbimeve të gjykatave kanë deklaruar që ndjehen (fizikisht) të sigurt në ndërtesat e gjykatave.

Rreth **69%** të përdoruesve të shërbimeve të gjykatave kanë deklaruar që nuk kanë njohuri që mund të parashtrijnë ankesa për shkelje disiplinore të gjykatësve.

Rreth **45%** të përdoruesve të shërbimeve të gjykatave mendojnë që nuk trajtohen në mënyrë të paanshme nga gjykatësit ose trajtohen ashtu vetëm deri në një masë. Ndarja e të dhënave sipas gjinisë reflekton të njëjtën ndjenjë edhe në mesin e grave e edhe të burrave.

### Prevalenca e korrupsionit:

**97.04%** e të anketuarve asnjëherë nuk u është kërkuar ryshfet apo mito nga gjykatësit ose punonjësit e gjykatës apo palë të treta që kanë vepruar në emër të tyre.

**98.5%** e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave kanë deklaruar që ata asnjëherë nuk u kanë ofruar ryshfet gjykatësve apo punonjësve të gjykatës.

## Të gjeturat e vëzhgimit në gjykatore:

Në **97.49%** e seancave të monitoruara ka qenë i siguruar përkthimi.

Në **93%** të rasteve, personat që kanë hyrë në gjykatore janë përshëndetur nga stafi i gjykatës.

Në **96.9%** të seancave gjyqësore të monitoruara, gjykatësit ose stafi i gjykatës kanë prezentuar rregullat e sjelljes në gjykatë që në fillim të seancës gjyqësore.

Në **95%** të rasteve të monitoruara, gjykatësit kanë ofruar një përmbledhje të procesit të seancës gjyqësore, edhe sa i përket seancës specifike por edhe të gjithë procesit të gjykimit.

Në **95.6%** të rasteve të vëzhguara, gjykatësit kanë mbajtur kontaktin me sy me palët gjatë zhvillimit të seancës.

Në **99.2%** të seancave gjyqësore të monitoruara, gjykatësit kanë pasur paraqitje profesionale dhe kanë folur në mënyrë të qartë e të qetë.

Në **98.8%** të seancave të monitoruara, gjykatësit janë siguruar që palët i kanë kuptuar të drejtat e tyre.

Në **94%** të seancave të monitoruara, të gjithë folësit duke përfshirë gjykatësit, avokatët dhe palët janë dëgjuar mirë gjatë kohës sa kanë folur.

Në **99%** të seancave gjyqësore të vëzhguara, gjykatësit kanë shpjeguar qartazi se çka duhet të bëjnë palët që të jenë në linjë me pritshmëritë e gjykatës, rregulloret e brendshme dhe/ose verdiktet.

Në **97.3%** të seancave të vëzhguara, palëve u është lejuar të bëjnë pyetje ose të japin komente.

Në **99%** të seancave të vëzhguara, gjyqtari/ja ka përdorur gjuhë të thjeshtë për të shpjeguar termet ligjore apo shkurtesat.

Në **69.39%** të seancave të monitoruara, emrat e gjykatësve nuk ishin të vendosur në mënyrë të dukshme në bankën e trupit gjykues, ndërsa në raste të tjera (rreth 30%) kur emri nuk ishte i dukshëm, kjo ndodhte kryesisht në ato raste kur seancat janë mbajtur në zyrat e gjykatësve.

Në **34.46%** seancat gjyqësore nuk kanë filluar në kohën e paraparë.

# Hyrje

**Demokrai Plus (D+)**, me përkrahje të **Aktivitetit të USAID për Drejtësi** ka realizuar dy anketa për të vlerësuar zbatimin e Drejtësisë Procedurale në të shtatë gjykatat themelore në Kosovë dhe për tu ofruar këtyre gjykatave rekomandime të bazuara në hulumtim se si ta përmirësojnë këtë aspekt. Anketa e parë, përkatësisht anketa me përdoruesë të shërbimeve të gjykatave, është realizuar në hyrje të ndërtesës së gjykatës, përderisa anketa e dytë, anketa e vëzhgimit të përvojës në gjykatore është realizuar brenda gjykatores. Anketa e parë është ndërtuar mbi Vlerësimet e Qytetarëve për Shërbimet e Gjykatave të realizuar nga D+ në vitet e kaluara (2018 dhe 2020) dhe të mbështetura nga USAID.

Struktura e anketës ofron të dhëna mbi statusin e qasjes në informacion dhe transparencë, efikasitet dhe paanshmëri, dhe prevalencës të korrupsionit në shtatë gjykatat themelore. Meqenëse, kjo anketë ka pasuar vlerësimet e qytetarëve të realizuara në të kaluarën, janë bërë edhe vlerësime dhe krahasime përgjatë viteve 2018-2021 duke ofruar të dhëna për progresin/regresin e arritur në dimensionet e vlerësuara. Anketa e dytë ka mbledh të dhëna për mënyrën se si janë trajtuar palët gjatë seancave gjyqësore apo gjykimit. Për qëllimi të kontributit për ta përmirësuar drejtësinë procedurale përgjatë shtatë gjykatave, ky punim ofron rekomandime të bazuara në hulumtim në pjesën e fundit.

**Aktiviteti i USAID për Drejtësi** është një program pesëvjeçar që synon fuqizimin e sektorit të drejtësisë përmes zbatimit të qasjes në drejtësi që ka në qendër qytetarin, me qëllim të përmirësimit të kapaciteteve të institucioneve për t'u ofruar qytetarëve qasje në shërbime cilësore dhe forma të ndryshme për zgjidhjen e nevojave të drejtësisë dhe problemeve të përditshme ligjore, dhe të gjenerojë besim më të madh publik në sistemin e drejtësisë dhe sundimin e ligjit. Ky aktivitet do të arrijë këtë përmes tri objektivave të ndryshme por që ndërlidhen ndërmjet vete:

### **Përmirësimit të cilësisë dhe qasjes së shërbimeve të drejtësisë**

Projekti i Drejtësisë mbështet përmirësimin e qasjes të qytetarëve në drejtësi përmes rritjes së drejtësisë procedurale, zgjerimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe vazhdimin të përmirësimit të politikave dhe praktikave të administrimit dhe menaxhimit në gjykata. Përmes këtyre përpjekjeve, aktiviteti do të mbështesë institucionet e Kosovës dhe akterët kryesorë për të kuptuar si duhet nevojat me prioritet të qytetarëve për të përmirësuar mekanizmat ekzistues ose për të identifikuar masa të reja që të sigurojë që të gjithë qytetarët marrin shërbime të drejta dhe të paanshme, dhe përdoruesit qytetarë të kuptojnë më mirë të drejtat e tyre ligjore dhe procedurat gjyqësore.

### **Përmirësimit të të kuptuarit qytetarë, angazhimit dhe besimit në sistemin e drejtësisë**

Projekti i Drejtësisë i angazhon komunitetet dhe profesionistët në përcaktimin e problemeve dhe propozimin e përmirësimeve në ofrimin e shërbimeve juridike dhe informacionit tek kërkuesit e ndryshëm të drejtësisë atje ku ata jetojnë dhe në çështjet me të cilat shpesh përballen. Duke punuar përmes një game të gjerë akterësh dhe palësh kryesore, Projekti i Drejtësisë do të krijojë rrjete kritike (përfshirë komunitetin për praktikë për zyrtarët e informacionit publik, forumet e profesionistëve) brenda komuniteteve për të mbledhur nevojat e kërkuesve të drejtësisë dhe për të luajtur një rol aktiv në identifikimin e zgjidhjeve. Përmes këtyre përpjekjeve, Projekti i Drejtësisë synon të përmirësojë ndërvëprimin e qytetarëve me ofruesit e shërbimeve të drejtësisë, duke kërkuar fidbek dhe hulumtim dhe duke shkëmbyer informacion mbi ofrimin e shërbimeve të drejtësisë.

### **Zhvillimit të inovacionit efektiv në sektorin e drejtësisë**

Projekti i Drejtësisë mbështet krijimin e një Inkubatori për Inovacionin në Drejtësi që do të drejtojë kapacitetin për të bërë inovacion bazuar në sfidat me të cilat përballen institucionet e drejtësisë dhe përdoruesit e saj. Në paradigmen e drejtësisë me në qendër njerëzit, këto inovacione do të rrisin mirëdashjen e përdoruesve të politikave dhe procedurave, do të rrisin përballueshmërinë dhe qasjen e shërbimeve të drejtësisë, ose do të përmirësojnë ndjenjat e kërkuesve të drejtësisë në paanësi dhe besim në sistemin e drejtësisë.

**D+** është një organizatë e pavarur dhe jofitimprurëse e themeluar nga një grup aktivistësh që besojnë në fuqizimin e mëtutjeshëm të vlerave demokratike në Kosovë. Qëllimi kryesor i D+ është fuqizimi i vlerave dhe praktikave demokratike që do të fuqizojnë tutje zërin e shoqërisë kosovare.

D+ synon që të kontribuojë në krijimin e praktikave të mira për qeverisje të mirë, fuqizimin e sundimit të ligjit, përkrahjen e proceseve të lira dhe të drejta zgjedhore dhe fuqizimin e respektimit të të drejtave të njeriut dhe çështjeve sociale. D+ ka realizuar projekte të ndryshme që kanë për qëllim përafrimin e vendimmarrësve me qytetarët përmes hulumtimit të politikave, lehtësimit të dialogut e intëarktivitetit, si dhe aktivitetet e edukimit publik.








# Metodologjia

Me qëllim të vlerësimit të zbatimit të drejtësisë procedurale në të shtatë gjykatat themelore të Kosovës, D+ ka realizuar dy anketa duke përfshirë anketën jashtë gjykatës danketën e vëzhgimit të përvojës në gjykatore.

## Anketa me përdorues të shërbimeve të gjykatave

D+ ka realizuar një numër prej 1357 anketash valide në shtatë gjykatat themelore, duke përfshirë Gjykatën Themelore të Prishtinës, Gjykatën Themelore të Ferizajt, Gjykatën Themelore të Gjilanit, Gjykatën Themelore të Prizrenit, Gjykatën Themelore të Gjakovës, Gjykatën Themelore të Pejës dhe Gjykatën Themelore të Mitrovicës (të Jugut dhe Veriut). Numri i përgjithshëm i anketave valide të realizuara për secilën gjykatë dhe përqindja e përgjithshme për secilën gjykatë janë paraqitur në tabelën nr. 1:

**TABELA 1.** Numri i përgjithshëm i anketave të realizuara

Gjykatat <sup>1</sup>	Totali	%
 Ferizaj	158	11.6%
 Gjakovë	144	10.6%
 Gjilan	146	10.7%
 Mitrovicë	164	12%
 Pejë	171	12.6%
 Prishtinë	409	30%
 Prizren	165	12.1%

<sup>1</sup> Gjykatat janë renditur në mënyrë alfabetike në komplet tekstin.

Kjo anketë është realizuar nga anketues të angazhuar nga D+ në periudhën shtator dhe tetor 2021, në hyrje të ndërtesave të gjykatave themelore dhe janë realizuar me përdorues që kanë raste aktive në gjykata. Nga shtatë gjykatat themelore, dy prej tyre, ajo e Mitrovicës dhe Ferizajit kanë qenë pilote, prandaj anketimi ishte kryer më herët, në shtator të 2021. Ndërkaq në pesë gjykata tjera, anketimi është bërë në tetor të të njejt vit.

Të anketuarit janë zgjedhur në mënyrë rastësore, përkatësisht çdo i pesti person që ka dalë nga ndërtesa e gjykatës, i është kërkuar që t'u përgjigjet pyetjeve të pyetësorit. Realizimin e intervistave, anketuesit e D+ e kanë bërë përgjatë një muaji, megjithëse, në disa gjykata numri i parazaktuar i anketave ishte arritur më herët. Është me rëndësi të theksohet që për shkak të konfidencialitet të të dhënave, anketa nuk përmban informacione për emrat dhe mbiemrat e personave të anketuar. Kjo anketë (Shtojca A) u përbë nga 57 pyetje që përfshinin dimensione si qasja në informacion, transparencë, efikasitet, paanshmëria, prevalenca e korrupsionit dhe një seri pyetjesh shtesë të ndërlidhura me përvojat e përdoruesve të shërbimeve në gjykatore gjatë seancave gjyqësore. Asnjë nga këto dimensione nuk ka për qëllim vlerësimin e këtyre koncepteve nga institucionet apo agjencitë zhvillimore, por synojnë vetëm perspektivën dhe përvojën e dorës së parë të përdoruesve të shërbimeve të gjykatave.

## Variablat

**QASJA NË INFORMACION** është matur përmes të dhënave të lidhura me (1) lehtësinë e sigurimit të informacionit rreth rastit; (2) dobishmërinë e informacionit të dhënë nga gjykatat; (3) përvojën në gjetjen e gjykatores apo zyrës që u nevojitej; (4) disponueshmërinë e kutive të ankesave; (5) disponueshmërinë e këndeve të informacionit në gjykatore.

**TRANSPARENCA** është matur përmes të dhënave të lidhura me (1) përdorimin e informacioneve në ueb-faqen e gjykatës. Kjo pyetje është përcjellë me tri nënpyetje duke përfshirë (1.1) gjuhën e përdorur në përmbajtjen e ueb-faqes; (1.2) kënaqshmërinë me kualitetin e përkthimit; (1.3) llojin e informacionit të kërkuar në ueb faqen e gjykatës.

**EFIKASITETI** është matur duke përfshirë të dhëna nëse (1) koha e nevojshme për të kryer punë në gjykatë në ditën e anketimit të të anketuarit ka qenë e arsyeshme; (2) kohëzgjatja e rastit; (3) dhe kënaqshmëria me kohën që është dashur për rishikim të rastit.

**PAANSHMËRIA** është matur duke përfshirë të dhëna rreth (1) trajtimit të të anketuarve me mirësjellje dhe respekt nga ana e stafit të gjykatës; (2) perspektiva e të anketuarve rreth trajtimit të paanshmën nga ana e gjykatësve; (3) mundësia për të biseduar me stafin e gjykatës në gjuhë amtare; (4) ofrimi i përkthimit gjatë seancave; (5) pranimit i dokumenteve të gjykatës në gjuhën amtare të të anketuarit; (6) siguria në ndërtesa të gjykatave; (7) njohuria e të anketuarve rreth mundësisë së parashtrimit të ankesave për shkelje disiplinore të gjykatësve.

**PREVALENCA E KORRUPSIONIT** është matur përmes të dhënave (1) nëse të anketuarve u është kërkuar ryshfet, dhe (2) nëse ata kanë ofruar ryshfet.




































**PYETJET SHITESË** janë ndërlidhur me përvojat e përdoruesve të shërbimeve të gjykatës brenda gjykatores në seancë gjyqësore, duke përfshirë se (1) ku kishin shkuar në ndërtesë të gjykatës; (2) nëse ndjehen rehat që të parashtrorjnë ankesa rreth gjykatës dhe t'i vendosin ato në kuti të ankesave; (3) nëse kanë folur me ndokënd në këndin e informacionit; (4) shenja dhe informacioni për t'i kuptuar procedurat e sigurisë për të hyrë në ndërtesë dhe dobishmërinë e respektimit nga ana e personelit të sigurisë; (5) pastërtinë dhe mirëmbajtjen e ndërtesës; (6) shenjat e vendosura rreth ndërtesës dhe brenda gjykatores ishin të dukshme dhe lehtë të kuptueshme; (7) nëse kanë munguar në ngjarje personave që nga fillimi i rastit; (8) nëse u është dashur të kthehen prapë në gjykatë, a janë pyetur për datën më të përshtatshme për ta; (9) nëse ata janë trajtuar ndryshe se sa përdoruesit e tjerë të shërbimeve në gjykata dhe arsyet pse mendojnë që janë trajtuar ndryshe; dhe (10) nëse ata jenë ndjerë që kanë mundësi të bëjnë pyetje për të cilat kishin nevojë në ditën e anketimit.

**ANKETA E VËZHIMIT TË PËRVOJËS NË GJYKATORE** është dizajnuar për t'i mundësuar një vëzhguesi të pavarur që të mbledhë të dhëna rreth mënyrës se si trajtohen palët, specifiku në kontekst të seancës apo gjykimit në të shtatë gjykatat themelore. Anketuesit e D+ kanë realizuar kryesisht vëzhgime në gjykatore, por edhe në zyra të gjykatësve gjatë muajve shtator dhe tetor 2021. Anketat për dy gjykatat pilote (Gjykata Themelore e Mitrovicës dhe ajo e Ferizajt) janë realizuar gjatë monitorimit të seancave në muajin shtator, përderisa seancat e pesë gjykatave të tjera janë vëzhguar gjatë muajit tetor 2021.

Në dy gjykatat pilote, D+ ka realizuar vëzhgime në shkallën prej 100% të gjykatësve që kanë punuar në raste civile dhe penale, duke përfshirë krimet e rënda, dhe ka vëzhguar rreth 1-2 orë secilin gjykatës/e. Vëzhgimi nuk ka përfshirë rastet e të miturve dhe ato të kundërvajtjes.

Në pesë gjykatat e tjera (Prishtinë, Prizren, Gjilan, Gjakovë, Pejë), D+ ka realizuar minimalisht 1-2 orë vëzhgim për gjykatës që kanë punuar në raste penale dhe civile. Në krahasim me katër gjykatat e tjera, në Gjykatën Themelore të Prishtinës është përfshirë edhe Departamenti Administrativ, përderisa rastet e të miturve nuk janë përfshirë në asnjë nga gjykatat. Në përgjithësi, siç mund të shihet në tabelën e mëposhtme, anketuesit e D+ në terren, kanë vëzhguar 384.02 orë të seancave gjyqësore në të gjitha gjykatat themelore të Kosovës.

**TABELA 2. Numri i orëve të kaluara në vëzhgim të rasteve për secilën gjykatë**

Gjykata	Orët
Ferizaj	41.25    
Gjakovë	48.98    
Gjilan	56.97     
Mitrovicë	41.97    
Pejë	46.70    
Prishtinë	95.25         
Prizren	52.90     
<b>Totali</b>	<b>384.02</b>

Anketa e vëzhgimit të përvojës në gjykatore është përbërë nga 46 pyetje. Anketuesit vëzhguan nëse (a) senca ka filluar në kohën e paraparë, (b) në rast të vonesave, a ka kërkuar gjykatësi/ja falje, (c) a kanë mbajtur gjykatësit kontaktin me sy me palët gjatë seancës, (d) a u janë referuar gjykatësit palëve në emër, e pyetje të tjera. (Shih Shtojcën B për listën e pyetjeve).










## Të dhënat demografike

Të dhënat demokratike për të dy anketat janë të paraqitura më poshtë. Të dhënat demografike për anketën me përdoruesit e shërbimeve të gjykatave përfshijnë të dhënat e ndara sipas gjinisë, pastaj të ndara sipas përkatësisë etnike dhe sipas moshës. Në anën tjetër, të dhënat demografike për anketën e vëzhgimit të përvojës në gjykatore përfshijnë gjininë e gjykatësve dhe përkatësinë etnike të gjykatësve.

### (A) Anketa me përdoruesit e shërbimeve të gjykatave








Të dhënat e ndara sipas gjinisë tregojnë që nga 1,357 të anketuar, 241 ishin gra dhe 1,116 ishin burra. Tabela e mëposhtme tregon numrin e të anketuarve gra dhe burra sipas gjykatës themelore.

■ TABELA 3. Gjinia e të anketuarve

	 <b>Burra</b>	 <b>Gra</b>	<b>Totali</b>
 <b>Ferizaj</b>	126	32	<b>158</b>
 <b>Gjakovë</b>	103	41	<b>144</b>
 <b>Gjilan</b>	110	36	<b>146</b>
 <b>Mitrovicë</b>	143	21	<b>164</b>
 <b>Pejë</b>	160	11	<b>171</b>
 <b>Prishtinë</b>	343	66	<b>409</b>
 <b>Prizren</b>	131	34	<b>165</b>








Të dhënat e ndara sipas moshës janë paraqitur në tabelën në vijim:

■ **TABELA 4. Moshë e të anketuarve**

		15-17	18-24	25-34	35-44	45-54	55-64	Mbi 65+	Totali
	<b>Ferizaj</b>	1	25	50	36	26	10	10	<b>158</b>
	<b>Gjakovë</b>	2	21	33	22	24	21	21	<b>144</b>
	<b>Gjilan</b>	2	15	49	47	18	12	3	<b>146</b>
	<b>Mitrovicë</b>	0	13	57	46	30	16	2	<b>164</b>
	<b>Pejë</b>	3	19	43	44	45	16	1	<b>171</b>
	<b>Prishtinë</b>	0	8	84	130	140	35	12	<b>409</b>
	<b>Prizren</b>	1	19	56	54	23	10	2	<b>165</b>

Të dhënat e ndara sipas përkatësisë etnike janë paraqitur në tabelën në vijim:










■ **TABELA 5. Përkatësia etnike e të anketuarve**

		Shqiptarë	Serbë	Turq	Boshnjakë	Romë	Ashkali	Egjiptianë	Goranë	Të tjerë	Totali
	Ferizaj	141	0	2	1	10	4	0	0	0	<b>158</b>
	Gjakovë	127	0	0	0	5	8	4	0	0	<b>144</b>
	Gjilan	145	0	0	1	0	0	0	0	0	<b>146</b>
	Mitrovicë	78	50	0	19	12	5	0	0	0	<b>164</b>
	Pejë	145	3	0	13	0	7	1	0	2	<b>171</b>
	Prishtinë	406	1	0	1	0	1	0	0	0	<b>409</b>
	Prizren	155	0	1	5	0	3	1	0	0	<b>165</b>

## (B) Anketa e vëzhgimit të përvojës në gjykatore








Të dhënat e ndarjes sipas gjinisë së gjykatësve tregojnë që në 63% të seancave të monitoruara, kryesuesit e trupit gjykues ishin burra, ndërsa në 35% të rasteve ishin gra.

■ TABELA 6. Gjinia e gjykatësve

	 Burra	 Gra	Totali
 Ferizaj	73	30	<b>103</b>
 Gjakovë	42	34	<b>76</b>
 Gjilan	48	15	<b>63</b>
 Mitrovicë	66	36	<b>102</b>
 Pejë	32	31	<b>63</b>
 Prishtinë	58	23	<b>81</b>
 Prizren	33	29	<b>62</b>

Të dhënat e ndara sipas përkatësisë etnike të gjykatësve tregojnë përkatësinë etnike të kryesuesit/es të trupit gjykues.

■ **TABELA 7. Përkatësia etnike e gjykatësve**

		Shqiptarë	Serbë	Boshnjakë	Turq	Romë	Ashkali	Goranë	Të tjerë	Totali
	Ferizaj	103	0	0	0	0	0	0	0	<b>103</b>
	Gjakovë	76	0	0	0	0	0	0	0	<b>76</b>
	Gjilan	62	1	0	0	0	0	0	0	<b>63</b>
	Mitrovicë	41	61	0	0	0	0	0	0	<b>102</b>
	Pejë	63	0	0	0	0	0	0	0	<b>63</b>
	Prishtinë	81	0	0	0	0	0	0	0	<b>81</b>
	Prizren	48	0	14	0	0	0	0	0	<b>62</b>





# REZULTATET E ANKETËS ME PËRDORUESË TË SHËRBIMEVE TË GJYKATAVE








# Rezultatet e anketës me përdoruesë të shërbimeve të gjykatave

## Qasja në informacion dhe transparenca

**I. Qasja në informacion** është vlerësuar përmes një serie prej pesë pyetjesh dhe një nënpyetje duke përfshirë (1) lehtësinë e sigurimit të informacionit, (2) dobishmërinë e informatave të siguruar, (3) përvojën në gjetjen e gjykatorese ose zyres, përcjellë me nënpyetjen se çka do të mund ta lehtësonte procesin e gjetjes së tyre, (4) disponueshmërinë e kutisë së ankesave dhe (5) disponueshmërinë e këndit të informacionit.








Pyetja e parë që u ishte bërë përdoruesve të shërbimeve të gjykatave ishte për të vlerësuar nivelin e lehtësisë së sigurimit të informacionit për rastet e tyre, përdoruesit patën mundësinë të zgjedhin ndërmjet katër kategorive a) tejet e vështirë, b) deri diku e vështirë, c) deri diku e lehtë, d) tejet e lehtë. Sipas rezultateve të anketës, në pesë nga shtatë gjykatat themelore, mbi 50% e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave deklaruan që është deri diku e lehtë të sigurohen informacionet. Përqindja më e lartë e të anketuarve që deklaruan se ishte tejet e lehtë të sigurohen informacionet ishin në Gjakovë (44.44%), pastaj në Prizren (24.85%) dhe Mitrovicë (24.39%). Në anën tjetër, në Gjykatën Themelore në Pejë përqindja më e lartë e të anketuarve janë deklaruar që e kanë pasur tejet të vështirë që të gjejnë informacione (34.94%). Këto të dhëna tregojnë që siguri i informacioneve rreth rasteve nuk është sfidë e madhe në asnjërën nga shtatë gjykatat themelore.

**TABELA 8.** Sipas përvojës suaj, sa ka qenë e lehtë që të merrni informata nga gjykata për lëndën tuaj?

	Tejet e vështirë	Deri diku e vështirë	Deri diku e lehtë	Tejet e lehtë
 Ferizaj	3.16%	24.05%	56.33%	16.46%
 Gjakovë	4.86%	13.20%	37.50%	44.44%
 Gjilan	15.07%	23.97%	38.36%	22.60%
 Mitrovicë	7.93%	17.68%	50.00%	24.39%
 Pejë	34.94%	1.81%	52.41%	10.84%
 Prishtinë	8.31%	25.67%	58.68%	7.34%
 Prizren	9.09%	9.70%	56.36%	24.85%








Sa i përket dobishmërisë së informacioneve të marra nga gjykatat, të dhënat tregojnë që informacionet e ofruara kanë qenë të *dobishme* apo *deri diku të dobishme*. Në anën tjetër, 5.7% e të anketuarve thanë se informatat ishin tejet të *padobishme*, ndërsa numri më i madh i të anketuarve ishin në Pejë (18.67%), që e bënë këtë gjykatën e vetme me numër dyshifror të përgjigjeve për këtë kategori.

■ **TABELA 9. Sa ishin të dobishme informatat që u janë dhanë nga gjykata?**

		<b>Tejet të padobishme</b>	<b>Deri diku të padobishme</b>	<b>Deri diku të dobishme</b>	<b>Tejet të dobishme</b>
	<b>Ferizaj</b>	0.00%	10.76%	65.82%	23.42%
	<b>Gjakovë</b>	3.47%	9.03%	54.17%	33.33%
	<b>Gjilan</b>	2.05%	2.74%	26.03%	69.18%
	<b>Mitrovicë</b>	4.27%	7.93%	29.27%	58.53%
	<b>Pejë</b>	18.67%	3.01%	66.27%	12.05%
	<b>Prishtinë</b>	2.45%	14.67%	60.88%	22.00%
	<b>Prizren</b>	9.09%	6.67%	70.91%	13.33%





Më tutje, të anketuarit u pyetën se çfarë përvojë kishin në gjetjen e gjykatoreve apo zyrës që po kërkonin, ku kishin mundësi të zgjedhin ndërmjet katër kategorive a) tejet e vështirë, b) deri diku e vështirë, c) deri diku e lehtë, dhe d) tejet e lehtë. Rezultatet tregojnë që 90% e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave në shtatë gjykatat themelore deklaruan që ishte *deri diku e lehtë* apo *tejet e lehtë* të gjenden gjykatorka dhe zyrat që po kërkonin. Në anën tjetër, përqindja e atyre që deklaruan se ishte *tejet e vështirë* të gjenden gjykatorka dhe zyrat ishte e ulët dhe variante nga 0 (në Gjilan dhe Ferizaj) deri në 3.61 % (Pejë). 14 nga 1357 të anketuar deklaruan që përvoja e tyre në gjetjen e lokacionit që u duhej ishte *tejet e vështirë*.

■ TABELA 10. A ishte e lehtë ta gjeni gjykatoren apo zyrën që ju duhej?

	Tejet e vështirë	Deri diku e vështirë	Deri diku e lehtë	Tejet e lehtë
 Ferizaj	0.00%	4.43%	67.72%	27.85%
 Gjakovë	1.39%	0.00%	31.94%	66.67%
 Gjilan	0.00%	4.80%	11.64%	83.56%
 Mitrovicë	1.22%	7.32%	60.97%	30.49%
 Pejë	3.61%	2.41%	50.00%	43.98%
 Prishtinë	0.73%	1.47%	55.75%	42.05%
 Prizren	0.60%	0.61%	16.97%	81.82%

Kjo pyetje u përcoll me një pyetje të hapur ndaj të anketuarve që deklaruan se ishte tejet e vështirë apo *deri diku* e vështirë që ta gjejnë gjykatoren ose zyrat që po kërkonin. Ata u pyetën se çfarë do ta lehtësonte këtë përvojë në gjetjen e lokacionit. Disa përgjigje, siç mund të shihet në tabelën më poshtë përfshijnë përcjelljen nga dikush prej këndit të informacionit që do t'u ndihmonte deri te gjykatorka ose zyra, shenja të vendosura më mirë e masa të reja.

### Çka do të mund të ndihmonte në këtë aspekt?








Numri i komenteve	Komentet
 25	Shenjzimi më i mirë dhe më i qartë do të ishte ndihmesë
 7	Me informacione në këndin e informacionit do të ndihmonin
 2	Sistemi i funksionimit duhet të ndryshojë
 1	Do të ishte e mirëseardhur nëse do të flisnin gjuhën shqipe

■ TABELA 11. Përgjigjet nga shtatë gjykatat themelore janë grupuar në katër kategori








Për më shumë, përdoruesit e shërbimeve të gjykatave u pyetën nëse gjykatat themelore kishin kutinë e ankesave dhe këndin e informacionit. Të dhënat tregojnë që një numër i konsiderueshëm i të anketuarve nuk e dinë që ka kuti të ankesave. Në gjashtë nga shtatë gjykatat themelore, përqindja e atyre që nuk kanë njohuri rreth ekzistencës së kutive të ankesave lëvizte nga 40.61% – 77.08% (në total 53.38% e të gjithë të anketuarve nuk e dinin se ekzistojnë kutitë e ankesave). Në anën tjetër, pjesa më e madhe e të anketuarve u përgjigjën pozitivisht rreth kutive të ankesave në Mitrovicë (68.29%).

Ndryshe nga të gjeturat e anketës rreth kutive të ankesës, shumica e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave u përgjigjën pozitivisht rreth ekzistencës së këndeve të informacionit nëpër gjykatoret e tyre. Siç mund të shihet në tabelën 13, përqindja e përgjigjeve pozitive lëviz nga 55% deri te 91% në gjashtë gjykatat, përderisa Gjykata Themelore në Ferizaj mbetet një rast përjashtues me vetëm 37% të përdoruesve të shërbimeve të gjykatave që u përgjigjën pozitivisht dhe numrin më të lartë të të anketuarve që e dinë se gjykatorka ka kënd të informacionit (rreth 60%).

■ TABELA 12. A ka gjykata kuti të ankesave?

	Po	Jo	Nuk e di
 Ferizaj	31.64%	1.90%	66.46%
 Gjakovë	20.83%	2.08%	77.09%
 Gjilan	43.15%	4.11%	52.74%
 Mitrovicë	68.29%	9.76%	21.95%
 Pejë	34.34%	0.00%	65.66%
 Prishtinë	50.12%	0.73%	49.15%
 Prizren	56.97%	2.42%	40.61%








■ TABELA 13. A ka gjykata kënd informativ?

	Po	Jo	Nuk e di
 Ferizaj	36.71%	2.53%	60.76%
 Gjakovë	86.11%	0.00%	13.89%
 Gjilan	91.78%	2.06%	6.16%
 Mitrovicë	55.49%	44.51%	0.00%
 Pejë	83.74%	0.60%	15.66%
 Prishtinë	73.59%	0.25%	26.16%
 Prizren	89.70%	1.21%	9.09%

**II. Transparenca** është vlerësuar përmes në pyetjeje kyçe të ndërlidhur me përdorimin e ueb-faqes së gjykatës si dhe tri nënpyetje që kanë të bëjnë me a) informacionet që përdoruesit e shërbimeve të gjykatave kërkojnë; b) nëse është ofruar përkthimi dhe c) kualiteti i përkthimit të ofruar.

Secila gjykatë themelore e Kosovës ka ueb-faqe të qasshme, megjithatë, sikur edhe vitet e kaluara<sup>2</sup>, shumica e përdoruesve të shërbimeve të gjykatës nuk e vizitojnë ueb-faqen për t'u informuar. Në të shtatë gjykatat themelore, përqindja e përdoruesve që u përgjigjën negativisht lëvizte nga 46.99% - 97.22% apo 79% nga 100%. Në anën tjetër, pjesa më e madhe e të anketuarve që përdorin ueb-faqen e komunës për t'u informuar janë në Gjykatën Themelore të Pejës (51.01%). Gjashta gjykatat e tjera kanë një përqindje dukshëm më të ulët të përdoruesve të shërbimeve të gjykatave që janë përgjigjur pozitivisht duke lëvizur nga 2.78% në Gjakovë deri në 27.14% në Prishtinë. Përgjithësisht, këto të dhëna tregojnë që përdorimi i ueb-faqeve mbetet një problem sistematik (1,048 nga 1,357 të anketuar janë përgjigjur negativisht).








■ **TABELA 14. A e përdorni faqen e internetit të gjykatës si burim informacioni?**

	Po	Jo
 Ferizaj	22.78%	77.22%
 Gjakovë	2.78%	97.22%
 Gjilan	6.85%	93.15%
 Mitrovicë	19.51%	80.49%
 Pejë	53.01%	46.99%
 Prishtinë	27.14%	72.86%
 Prizren	13.94%	86.06%

2 Demokraci Plus, "Vlerësimi i shërbimeve të gjykatave themelore", prill 2020. E qasshme në <https://gjykata.dplus.org/wp-content/uploads/2020/08/04-Report-Citizens-ALB-11.pdf> (qasur së fundmi me 7 dhjetor, 2021).








Të anketuarve që u përgjigjën pozitivisht rreth përdorimit të ueb-faqes së gjykatës (rreth 22% në të shtatë gjykatat themelore) ju parashtruan edhe tri nënpyetje për të mbledhë informacione për llojin e të dhënave që ata i kërkojnë, nëse informacioni është i përkthyer në gjuhën e tyre amtare dhe për kualitetin e përkthimit. Të gjeturat e anketës tregojnë që përdoruesit e shërbimeve të gjykatave vizitojnë ueb-faqet e gjykatave kryesisht për të parë orarin e seancave, pastaj për lajme, për vendimet e publikuara, informacione për gjykatësit dhe kontakte.

■ **TABELA 15. Çfarë informacioni kërkon zakonisht në faqen e internetit të gjykatës? (pyetje me më shumë se një opsion)**

		Orarin e seancave	Kontakte	Lajme	Vendimet e publikuara	Informata për gjyqtarët	Tjetër
 <b>Ferizaj</b>		35.80%	12.35%	6.17%	24.69%	19.75%	1.24%
 <b>Gjakovë</b>		25.00%	0.00%	50.00%	25.00%	0.00%	0.00%
 <b>Gjilan</b>		30.00%	10.00%	30.00%	30.00%	0.00%	0.00%
 <b>Mitrovicë</b>		51.02%	6.12%	20.41%	14.29%	8.16%	0.00%
 <b>Pejë</b>		26.31%	9.94%	50.88%	10.53%	2.34%	0.00%
 <b>Prishtinë</b>		21.96%	16.40%	20.11%	22.75%	18.78%	0.00%
 <b>Prizren</b>		42.43%	3.03%	24.24%	21.21%	6.06%	3.03%








Për më shumë, ata u pyetën nëse përmbajtja e ueb-faqes së gjykatës ishte përkthyer në gjuhën e tyre amtare dhe vetëm pesë përdoruesë të shërbimeve në shtatë gjykatat themelore u përgjigjën negativisht (një në Prishtinë dhe katër në Pejë). Ky numër tejet i ulët tregon që përkthimi nuk është një problem. Për më shumë, ata u pyetën nëse ishin të kënaqur me përkthimin e ofruar, dhe vetëm një person i anketuar (në Prishtinë) deklaroi që nuk ishte i/e kënaqur me përkthimin.

■ **TABELA 16. A është përmbajtja e faqes së internetit në gjuhën tuaj amtare<sup>3</sup>?**

	Po	Jo	Numri i përgjithshëm
 Ferizaj	1	0	<b>9</b>
 Gjakovë	0	0	<b>1</b>
 Gjilan	0	0	<b>0</b>
 Mitrovicë	32	0	<b>0</b>
 Pejë	5	4	<b>32</b>
 Prishtinë	0	1	<b>1</b>
 Prizren	0	0	<b>0</b>

3 SHËNIM: Numri i të anketuarve që janë përgjigjur pozitivisht në pyetjen e 14-të është i vogël, si rrjedhojë numri i të anketuarve që u janë përgjigjur dy nën-pyetjeve (15 dhe 16) është i vogël, kështu që të dhënat janë të vendosura me numra, për të ofruar një pasqyrë më të qartë të gjendjes në terren.

**TABELA 17. A jeni të kënaqur me kualitetin e përkthimit të përmbajtjes së faqes së internetit<sup>4</sup>?**

	Po	Jo	Numri i përgjithshëm
 Ferizaj	1	0	<b>1</b>
 Gjakovë	0	0	<b>0</b>
 Gjilan	0	0	<b>0</b>
 Mitrovicë	32	0	<b>32</b>
 Pejë	9	0	<b>9</b>
 Prishtinë	0	1	<b>1</b>
 Prizren	0	0	<b>0</b>















## Renditja e përgjithshme e gjykatave rreth qasjes në informacion dhe transparencë

Të gjitha gjykatat themelore renditen nga një deri në shtatë për sa i përket qasjes në informacion dhe transparencës, ku niveli një do të thotë se gjykata qëndron krahasimisht më mirë se sa gjykatat e tjera, ndërsa shtatë do të thotë se qëndron më dobët se gjykatat e tjera. Pikët për secilën gjykatë janë kalkuluar duke marrë për bazë pikët mesatare të dala nga numri i përgjigjeve pozitive dhe negative që i kanë dhënë të anketuarit, përkitazi me pyetjet e listuara më lart.

Qasja në informacion dhe transparenca janë vlerësuar duke marrë për bazë pyetjet në vijim:

1. Sipas përvojës suaj, sa është e lehtë që të merrni informata nga gjykata për lëndën tuaj?
2. Sa ishin të dobishme informatat që u janë dhanë nga gjykata?
3. A ishte e lehtë të gjeni gjykatoren apo zyrën që ju duhej?
4. A ka gjykata kuti të ankesave?
5. A ka gjykata kënd informativ?
6. A e përdorni faqen e internetit të gjykatës si burim informacioni?
7. Për çfarë informatash kërkoni kryesisht nëpër faqe të internetit të gjykatës?
8. A është përmbajtja e faqes së internetit në gjuhën tuaj amtare?
9. A jeni të kënaqur me kualitetin e përkthimit të përmbajtjes së faqes së internetit?

<sup>4</sup> Po aty.

Renditja	Gjykata Themelore
 <b>Vendi i parë</b>	 Mitrovicë
 <b>Vendi i dytë</b>	 Gjilan
 <b>Vendi i tretë</b>	 Prishtinë
 <b>Vendi i katërt</b>	 Prizren
 <b>Vendi i pestë</b>	 Gjakovë
 <b>Vendi i gjashtë</b>	 Pejë
 <b>Vendi i shtatë</b>	 Ferizaj








## Efikasiteti dhe paanshmëria

- Efikasiteti** është vlerësuar duke përfshirë të dhëna që ndërlidhen me (1) arsyeshmërinë e kohës që nevojitet për të përfunduar një punë në gjykatë në ditën kur janë pyetur të anketuarit; (2) vjetërsinë apo kohëzgjatjen e rasteve; (3) kënaqshmërinë me kohën brenda së cilës është shqyrtuar rasti i tyre.

Ngjashëm edhe me të gjeturat e vitit të kaluar, të dhënat e anketës<sup>5</sup>, tregojnë që shumica e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave kanë arritur të përfundojnë punët brenda një kohe të arsyeshme gjatë ditës kur kanë shkuar në gjykatë. Arsyeshmëria e kohëzgjatjes së kërkuar për kryerjen e punëve u është lënë në diskrecion secilit të anketuar. Të dhënat tregojnë që 67.58% e të anketuarve kanë arritur të kryejnë punët në gjykatë brenda një kohe të arsyeshme në ditën që është vizituar gjykata. Gjykata që prinë në këtë aspekt është ajo e Mitrovicës me 84.76%, e përcjellur nga gjykata e Ferizajt (82.28%), e Pejës (71.08%), Gjakovës (69.44%), Prizrenit (67.27%), Prishtinës (59.90%) dhe Gjilanit (38.36%). Në anën tjetër, rreth 32% nuk kanë arritur ta përfundojnë punën për të cilën kishin shkuar.








5 Demokraci Plus, "Citizen's Score on Basic Court Services", prill 2020. Gjetet në: <https://gjykata.dplus.org/en/reports/> (qasur me 10 dhjetor, 2021).

**TABELA 18.** A keni arritur të kryeni punë në gjykatë brenda një kohe të arsyeshme sot?

	Po	Jo
 Ferizaj	82.28%	17.72%
 Gjakovë	69.44%	30.56%
 Gjilan	38.36%	61.64%
 Mitrovicë	84.76%	15.24%
 Pejë	71.08%	28.92%
 Prishtinë	59.90%	40.10%
 Prizren	67.27%	32.73%

Në aspekt të matjes së efikasitetit, të anketuarit janë pyetur edhe për kohëzgjatjen e rastit të tyre dhe atyre u është mundësuar që të zgjedhin në mes të shtatë periudhave kohore apo kategorive, duke përfshirë a) më pak se gjashtë muaj, b) deri në një vit; c) deri në dy vite; d) deri në tri vite; e) deri në katër vite; f) më shumë se pesë vite; dhe g) mbi 10 vite.

■ TABELA 19. Për sa kohë është rasti juaj në proces?








	Më pak se gjashtë muaj	Deri në 1 vit	Deri në 2 vite	Deri në 3 vite	Deri në 4 vite	Deri në 5 vite	Mbi 10 vite
 <b>Ferizaj</b>	32.91%	24.68%	17.72%	15.19%	6.33%	3.17%	0.00%
 <b>Gjakovë</b>	70.83%	19.45%	6.25%	2.78%	0.00%	0.69%	0.00%
 <b>Gjilan</b>	41.10%	29.45%	15.07%	5.48%	4.11%	2.74%	2.05%
 <b>Mitrovicë</b>	7.92%	32.32%	31.71%	12.80%	6.71%	7.93%	0.61%
 <b>Pejë</b>	24.09%	22.29%	22.29%	15.06%	7.23%	6.63%	2.41%
 <b>Prishtinë</b>	5.62%	19.56%	28.85%	27.87%	11.98%	3.67%	2.45%
 <b>Prizren</b>	21.82%	38.18%	16.97%	12.73%	3.03%	4.85%	2.42%

Shumica e përgjigjeve bëjnë pjesë në kategorinë e parë (më pak se gjashtë muaj), në kategorinë e dytë (deri në një vit) dhe në kategorinë e tretë (deri në dy vite). Së pari, përqindja e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave që kanë pretenduar se rastet e tyre janë në proces për më pak se gjashtë muaj ka lëvizur nga 7.93% në Mitrovicë në 70.83% në Gjakovë (përkatësisht 326 nga 1,357 të anketuar). Së dyti, përqindja e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave që kanë pretenduar se rastet e tyre janë në proces për një periudhë deri në një vit, ka lëvizur nga 22.29% në Pejë deri në 38.18% në Prizren (përkatësisht 342 nga 1,357 të anketuar). Së treti, përqindja e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave që kanë pretenduar se rastet e tyre janë në proces për një periudhë deri në dy vite ka lëvizur nga 6.25% deri në 31.71% (295 nga 1,357 të anketuar). Kështu, 963 të anketuar nga 1,357 (apo 70%) e të gjithë të anketuarve kanë raste në proces nëpër gjykata për më pak se gjashtë muaj, një vit dhe dy vite nëpër të shtatë gjykatat themelore. Në anën tjetër, 4.2% (59 nga 1,357 të anketuar) e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave kanë raste në proces për më se pesë vite, ndërsa 1.6% (22 nga 1,357 të anketuar) kanë raste nëpër gjykata për më se 10 vite.

Për më shumë, dimensionimi i tretë i transparencës për të cilën janë pyetur të anketuarit kishte të bënte me kënaqshmërinë rreth kohëzgjatjes së shqyrtimit të rastit të tyre. Të dhënat e anketës kanë treguar që në pesë gjykata themelore (në Mitrovicë, Pejë, Gjilan, Ferizaj, dhe Prizren) mbi 40% (570 nga 1,357 të anketuar) kanë deklaruar të jenë *deri diku të kënaqur* me kohëzgjatjen që po merr shqyrtimi i rastit të tyre. Një përqindje e konsiderueshme e të anketuarve nga Gjakova (27.78 %) dhe Gjilani (31.51 %) kanë thënë që janë të kënaqur (182 nga 1,357 të anketuar).

Në anën tjetër, përqindja më e madhe e të anketuarve që janë të pakënaqur gjenden në Gjykatën Themelore të Prishtinës (36.43%), përcjellur nga Gjykata Themelore në Mitrovicë (32.93%), në Pejë (29.51%), Prizren (29.09%), Gjilan (11.64) dhe në Ferizaj (6.96%). Në përgjithësi, 61% e të anketuarve kanë thënë të jenë *deri diku të kënaqur* apo të kënaqur me kohëzgjatjen e shqyrtimit të rastit të tyre, përderisa 39% kanë thënë krejt të kundërtën – që janë të pakënaqur apo *deri diku të pakënaqur*.








■ TABELA 20. A jeni të kënaqur me kohën që po merr shqyrtimi i rastit tuaj?

	Të pakënaqur	Deri diku të pakënaqur	Deri diku të kënaqur	Të kënaqur
 Ferizaj	6.96%	17.09%	63.92%	12.03%
 Gjakovë	18.75%	16.67%	36.80%	27.78%
 Gjilan	11.64%	6.16%	50.69%	31.51%
 Mitrovicë	32.93%	4.88%	40.24%	21.95%
 Pejë	29.52%	1.81%	54.82%	13.85%
 Prishtinë	36.43%	32.52%	28.85%	2.20%
 Prizren	29.09%	24.85%	40.61%	5.45%

**II. Paanshmëria** është vlerësuar përmes një liste prej shtatë pyetjesh, duke përfshirë (1) trajtimin me mirësjellje dhe respektimin e të anketuarve nga stafi i gjykatave; (2) pikëvështrimi i të anketuarve ndaj trajtimit të paanshëm nga gjykatësit; (3) mundësia për të biseduar me stafin e gjykatës në gjuhën amtare të të anketuarve; (4) ofrimi i përkthimit gjatë seancave; (5) pranimi i dokumenteve të gjykatës në gjuhën amtare të të anketuarve; (6) siguria në objektet e gjykatave; (7) njohuritë e të anketuarve për mundësinë e bërjes së ankesave për shkelje disiplinore të gjykatësve. Trajtimi me respekt dhe mirësjellje është një dimension kyç i drejtësisë procedurale. Të gjeturat e anketës tregojnë një gjendje përgjithësisht të mirë sa i përket trajtimit të përdoruesve të shërbimeve të gjykatave me mirësjellje dhe respekt, nga ana e stafit të gjykatave.








Shumica e të anketuarve janë përgjigjur me – po (76%) dhe – deri në një masë (26%) në pyetjen se a janë trajtuar me mirësjellje dhe respekt, përkatësisht nga 77% e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave. Në anën tjetër, një numër konsiderueshëm i vogël i përdoruesve të shërbimeve të gjykatave është përgjigjur negativisht (3%). Këtu dallohet Ferizaj, ku 95.57 % e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave janë përgjigjur pozitivisht, përcjellë nga Gjilani (82.88%) dhe Prizreni (80.61%).

**TABELA 21. A jeni trajtuar me respekt dhe mirësjellje nga stafi i gjykatës?**








	Po	Jo	Deri në një masë
 Ferizaj	95.57%	0.00%	4.43%
 Gjakovë	56.94%	4.17%	38.89%
 Gjilan	82.88%	2.74%	14.38%
 Mitrovicë	76.83%	4.27%	18.90%
 Pejë	75.90%	1.21%	22.89%
 Prishtinë	74.08%	0.74%	25.18%
 Prizren	80.60%	6.67%	12.73%

Për më tepër, të dhënat janë ndarë sipas gjinisë për të kuptuar më mirë nëse ka dallime në trajtim të grave kundrejt burrave nga ana e stafit të gjykatës. Të gjeturat kanë treguar të njëjtin trajtim, siç tregohet në dy tabelat më poshtë.

**TABELA 22.** A jeni trajtuar me respekt dhe mirësjellje nga stafi i gjykatës? (Vetëm burra) 








	Po	Jo	Deri në një masë	Totali
 Ferizaj	122	0	4	<b>126</b>
 Gjakovë	58	5	40	<b>103</b>
 Gjilan	90	4	16	<b>110</b>
 Mitrovicë	108	7	28	<b>143</b>
 Pejë	116	2	37	<b>155</b>
 Prishtinë	252	3	88	<b>343</b>
 Prizren	106	10	15	<b>131</b>

**TABELA 23.** A jeni trajtuar me respekt dhe mirësjellje nga stafi i gjykatës? (Vetëm gra) 


	Po	Jo	Deri në një masë	Totali
 Ferizaj	29	0	3	<b>32</b>
 Gjakovë	24	1	16	<b>41</b>
 Gjilan	31	0	5	<b>36</b>
 Mitrovicë	18	0	3	<b>21</b>
 Pejë	10	0	1	<b>11</b>
 Prishtinë	51	0	15	<b>66</b>
 Prizren	27	1	6	<b>34</b>








Për më shumë, përdoruesit e shërbimeve të gjykatave janë pyetur nëse ata janë trajtuar në mënyrë të paanshme nga gjykatësit, ndërsa të dhënat e anketës kanë treguar që Gjykata Themelore në Ferizaj është lidere në këtë aspekt, ku 87.97% e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave pretendojnë të jenë trajtuar në mënyrë të paanshme nga gjykatësit e kësaj gjykate, përdërisa të anketurit në Prizren kanë pasur një përqindje më të vogël të përgjigjeve pozitive. Përgjithësisht, 92% e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave në të shtatë Gjykatat themelore janë përgjigjur pozitivisht (me “po” ose “deri në një masë”) kur janë pyetur rreth trajtimit të paanshëm nga gjykatësit, ndërsa pjesa tjetër prej 8% janë përgjigjur negativisht. Për këtë të fundit, udhëheq Mitrovica me 16.46%, e përcjellë nga Prizreni (15.76%) dhe Gjilani (10.27%).


■ TABELA 24. A vlerësoni që jeni trajtuar drejtë (fer) nga gjyqtari?








	Po	Jo	Deri në një masë
 Ferizaj	87.97%	1.90%	10.13%
 Gjakovë	53.47%	6.25%	40.28%
 Gjilan	41.78%	10.27%	47.95%
 Mitrovicë	48.17%	16.46%	35.37%
 Pejë	67.47%	2.41%	30.12%
 Prishtinë	52.08%	3.42%	44.50%
 Prizren	33.94%	15.76%	50.30%

Të dhënat janë ndarë sipas gjinisë për të kuptuar më mirë nëse ka dallime në trajtim të grave kundrejt burrave nga ana e gjykatësve. Të gjeturat kanë treguar të njëjtin trajtim, siç tregojnë dy tabelat më poshtë.

■ TABELA 25. A vlerësoni që jeni trajtuar drejtë nga gjykatësi/ja? (Vetëm burra) 








	Po	Jo	Deri në një masë	Totali
 Ferizaj	110	3	13	<b>126</b>
 Gjakovë	52	6	45	<b>103</b>
 Gjilan	37	11	62	<b>110</b>
 Mitrovicë	67	24	52	<b>143</b>
 Pejë	102	4	49	<b>155</b>
 Prishtinë	175	13	155	<b>343</b>
 Prizren	41	21	69	<b>131</b>

■ TABELA 26. A vlerësoni që jeni trajtuar drejtë nga gjykatësi/ja? (Vetëm gra) 

	Po	Jo	Deri në një masë	Totali
 Ferizaj	29	0	3	<b>32</b>
 Gjakovë	25	3	13	<b>41</b>
 Gjilan	24	4	8	<b>36</b>
 Mitrovicë	12	3	6	<b>21</b>
 Pejë	10	0	1	<b>11</b>
 Prishtinë	38	1	27	<b>66</b>
 Prizren	15	5	14	<b>34</b>








Një element tjetër i rëndësishëm i paanshmërisë është përdorimi i gjuhës, prandaj në këtë pjesë, të anketuarit janë përgjigjur në katër pyetje rreth kësaj teme. Në pyetjen e parë, ku janë pyetur nëse kanë pasur mundësi të flasnin me stafin e gjykatës në gjuhën e tyre amtare, përdoruesit e shërbimeve të gjykatave kanë vlerësuar pozitivisht të shtatë gjykatat. Specifikisht, 100% e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave në katër gjykata themelore (Prishtinë, Gjiilan, Ferizaj, dhe Prizren) janë përgjigjur pozitivisht, të përcjellur nga Peja (99.4%), Mitrovica (80.49%) dhe Gjakova (78.47%).

■ **TABELA 27. A ju është dhënë mundësia që të flisni në gjuhën tuaj amtare me personelin e gjykatës?**








	Po	Jo
 Ferizaj	100.00%	0.00%
 Gjakovë	78.47%	21.53%
 Gjiilan	100.00%	0.00%
 Mitrovicë	80.49%	19.51%
 Pejë	99.40%	0.60%
 Prishtinë	100.00%	0.00%
 Prizren	100.00%	0.00%

Sa i përket pyetjes së dytë, nëse gjykatat ofrojnë përkthim gjatë seancave gjyqësore, siç edhe shihet në tabelën e mëposhtme, shumica e të anketuarve kanë deklaruar që nuk ka pasur nevojë të ofrohet përkthimi. Megjithatë, në rast që ka pasur nevojë për përkthim, siç tregon tabela 28.A, shumica e konsiderueshme e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave e kanë vlerësuar si pozitiv ofrimin e përkthimit gjatë seancave gjyqësore. Në anën tjetër, një pjesë e vogël e të anketuarve që ka lëvizur nga 7.5% deri në 26.56% nëpër të gjitha gjykatat themelore janë përgjigjur negativisht (apo rreth 6% e totalit të përdoruesve të shërbimeve të gjykatave).

**TABELA 28. A ka ofruar gjykata përkthim gjatë seancave?**








	Po	Jo	Nuk është aplikuar
 Ferizaj	15.19%	0.00%	84.81%
 Gjakovë	32.64%	11.81%	55.56%
 Gjilan	25.34%	2.05%	72.60%
 Mitrovicë	81.10%	18.90%	0.00%
 Pejë	11.45%	11.45%	77.11%
 Prishtinë	1.96%	0.49%	97.56%
 Prizren	12.73%	0.00%	87.27%

**TABELA 28a.** A ka ofruar gjykata përkthim gjatë seancave?  
(Vetëm për rastet kur ka pasur nevojë për përkthim)?

	Po	Jo
 Ferizaj	100.00%	0.00%
 Gjakovë	73.44%	26.56%
 Gjilan	92.50%	7.50%
 Mitrovicë	81.10%	18.90%
 Pejë	50.00%	50.00%
 Prishtinë	80.00%	20.00%
 Prizren	100.00%	0.00%

Për më shumë, sipas gjetjeve të kësaj ankete, 94% e të anketuarve nëpër të gjitha gjykatat themelore që kanë deklaruar se u është ofruar përkthim, kanë thënë që kanë qenë *deri diku të kënaqur* apo *të kënaqur* me kualitetin e përkthimit, siç edhe shihet më poshtë. Në anën tjetër, një numër dukshëm i vogël i të anketuarve (vetëm 17 nga 289) kanë thënë që kanë qenë *të pakënaqur* apo *deri diku të kënaqur* me kualitetin e përkthimit.








■ **TABELA 29. A jeni të kënaqur me kualitetin e përkthimit gjatë seancave<sup>6</sup>?**

		<b>Të pakënaqur</b>	<b>Deri diku të pakënaqur</b>	<b>Deri diku të kënaqur</b>	<b>Të kënaqur</b>	<b>Totali</b>
	<b>Ferizaj</b>	0	1	15	8	24
	<b>Gjakovë</b>	10	1	10	26	47
	<b>Gjilan</b>	3	0	5	29	37
	<b>Mitrovicë</b>	0	0	12	121	133
	<b>Pejë</b>	0	0	5	14	19
	<b>Prishtinë</b>	2	0	4	2	8
	<b>Prizren</b>	0	0	5	16	21

6 SHËNIM: Të dhënat e prezantuara janë vetëm në numra për shkak të numrit të vogël të të anketuarve që kanë deklaruar se u është nevojitur përkthimi.








Tutje, të anketuarit janë pyetur edhe nëse i marrin dokumentet nga gjykata në gjuhën e tyre amtare. Të dhënat e nxjerra nga anketa tregojnë që shumica e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave nëpër të gjitha gjykatat themelore i marrin dokumentet në gjuhën e tyre amtare, përpos në atë të Gjakovës.

■ TABELA 30. A i pranoni/merrni dokumentet nga gjykata në gjuhën tuaj amtare?

	Po	Jo	Nganjëherë
 Ferizaj	99.37%	0.00%	0.63%
 Gjakovë	43.75%	11.11%	45.14%
 Gjilan	94.52%	0.69%	4.79%
 Mitrovicë	96.34%	0.00%	3.66%
 Pejë	95.18%	3.01%	1.81%
 Prishtinë	98.78%	0.00%	1.22%
 Prizren	95.15%	0.00%	4.85%





Tutje, dy pyetjet e fundit që u janë parashtruar përdoruesve të shërbimeve të gjykatave për të vlerësuar paanshmërinë kishin të bëjnë me sigurinë dhe njohuritë e tyre rreth mundësisë së ankimit për shkeljet disiplinore të gjykatësve. Të dhënat e anketës tregojnë që siguria në ndërtesat e gjykatave nuk është as problem e as sfidë. Kjo ngase, së paku 96% e të anketuarve në secilën gjykatë themelore janë përgjigjur pozitivisht kur janë pyetur nëse e ndjejnë veten fizikisht të sigurt brenda ndërtesës së gjykatës (1,337 nga 1,357 të anketuar janë përgjigjur pozitivisht).

■ **TABELA 31. A ndjeheni (fizikisht) të sigurtë në objektin e gjykatës?**

	Po	Jo
 <b>Ferizaj</b>	100.00%	0.00%
 <b>Gjakovë</b>	96.53%	3.47%
 <b>Gjilan</b>	100.00%	0.00%
 <b>Mitrovicë</b>	98.78%	1.22%
 <b>Pejë</b>	99.40%	0.60%
 <b>Prishtinë</b>	99.51%	0.49%
 <b>Prizren</b>	96.97%	3.03%

Ata që janë përgjigjur negativisht në këtë pyetje, u është parashtruar edhe një pyetje përcjellëse, se pse nuk janë ndjerë të sigurt në ndërtesën e gjykatës. Siç mund të shihet në tabelën e mëposhtme, arsyet e dhëna kanë të bëjnë me përkatësinë etnike që shkojnë deri te arsyet personale.








Nëse jo, pse nuk ndjeheni të sigurtë?

Numri i komenteve	Komentet
 3	Arsye personale
 1	Përkatësia etnike
 1	Jam ndjerë i/e kërcënuar për shkak që jam dënuar edhe pse jam i/e pafajshëm/me
 1	Jam kërcënuar
 1	Jam sulmuar
 1	Ndajë hapësirën e njëjtë me të akuzuarit
 1	Jam person me aftësi të kufizuara, ndërsa ndërtesa e gjykatës nuk e ka infrastrukturën e duhur për mua





■ TABELA 32. Përgjigjet nga shtatë gjykatat të grupuara në shtatë kategori nga autorja

Ngjashëm edhe me rezultatet e anketës së vitit të kaluar, shumica e përdoruesve të gjykatave (69% nga 100%) në pesë gjykata themelore janë përgjigjur negativisht në pyetjen se, a e dijnë që ata mund të bëjnë ankesa për shkelje disiplinore të gjykatësve. Këtu prinë gjykata në Gjakovë (95.14%), e përcjellë nga ajo në Gjilan (90.41%), në Ferizaj (89.24%), në Prishtinë (69.19%), dhe në Prizren (32.12%). Në anën tjetër, pjesa më e madhe e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave që janë përgjigjur pozitivisht janë në Pejë (65.06%) dhe në Mitrovicë (62.2%).

■ **TABELA 33. A jeni të informuar se mund të ankoheni për shkelje disiplinore të gjykatësve?**

	Po	Jo
 <b>Ferizaj</b>	10.76%	89.24%
 <b>Gjakovë</b>	4.86%	95.14%
 <b>Gjilan</b>	9.59%	90.41%
 <b>Mitrovicë</b>	62.20%	37.80%
 <b>Pejë</b>	65.06%	34.94%
 <b>Prishtinë</b>	30.81%	69.19%
 <b>Prizren</b>	32.12%	67.88%

Të anketuarit që deklarojnë se e dinë që mund të parashtrojnë ankesa për shkelje disiplinore të gjykatësve janë pyetur pastaj nëse e dinë se ku mund t'i parashtrojnë këto ankesa, ndërsa përgjigjet kanë qënë Këshilli Gjyqësor, kryesuesit e gjykatave, gjykata, policia, departamenti i përgjithshëm, etj.

Numri i komenteve	Komentet
 68	Polica
 52	Këshilli Gjyqësor
 50	Kryesuesit e gjykatave
 22	Gjykatat
 13	Zyra/ Komisioni për ankesa
 6	Departamenti i Përgjithshëm
 1	Zyra Qendrore
 1	Këndi informativ

■ **TABELA 34.** Përgjigjet e dhëna nga përdoruesit e shërbimeve të shtatë gjykatave janë kategorizuar nga autorja<sup>7</sup>















7 Këto përgjigje paraqesin opinionet e të anketuarve, por nuk janë domosdoshmërisht të sakta

## Renditja e përgjithshme e gjykatave sa i përket efikasitetit dhe paanshmërisë

Të gjitha gjykatat themelore janë renditur në nivelin nga një deri në shtatë sa i përket efikasitetit dhe paanshmërisë, ku një do të thotë që një gjykatë është krahasimisht më e mirë se të tjerat, ndërsa shtatë do të thotë se një gjykatë qëndron krahasimisht më dobët se gjykatat e tjera. Pikët për secilën gjykatë janë kalkuluar duke marrë për bazë mesataren e pikëve të dala nga numri i përgjigjeve pozitive dhe negative që kanë dhënë të anketuarit në listën e pyetjeve të bëra.

Efikasiteti dhe paanshmëria janë vlerësuar duke përdorur pyetjet në vijim:

1. A keni kryer punë në gjykatë brenda një kohe të arsyeshme sot?
2. Qe sa kohë është e hapur lënda juaj?
3. A jeni të kënaqur me kohën që po merr shqyrtimi i lëndës suaj?
4. A jeni trajtuar me mirësjellje dhe respekt nga personeli i gjykatës?
5. A vlerësoni që jeni trajtuar fer nga gjykatësit?
6. A ju është dhënë mundësia që të flisni në gjuhën tuaj amtare me personelin e gjykatës?
7. A ka ofruar gjykata përkthim gjatë seancave?
8. A jeni të kënaqur me kualitetin e përkthimit gjatë seancave?
9. A i pranoni/merrni dokumentet nga gjykata në gjuhën tuaj amtare?
10. A ndjeheni (fizikisht) të sigurt në objektin e gjykatës?








Renditja	Gjykatat themelore
 <b>Vendi i parë</b>	 Mitrivicë
 <b>Vendi i dytë</b>	 Ferizaj
 <b>Vendi i tretë</b>	 Gjilan
 <b>Vendi i katërt</b>	 Gjakovë
 <b>Vendi i pestë</b>	 Pejë
 <b>Vendi i gjashtë</b>	 Prizren
 <b>Vendi i shtatë</b>	 Prishtinë

## Prevalenca e korrupsionit

Prevalenca e korrupsionit është vlerësuar duke mbledhur të dhëna rreth asaj nëse përdoruesve të shërbimeve të gjykatave u është kërkuar mito apo ryshfet si dhe nëse vetë ata kanë ofruar mito apo jo. Pyetja e parë është shoqëruar edhe me nënpyetjen, se cila ka qenë arsyeja e kërimit apo ofrimit të mitos. Pyetja e dytë pastaj është shoqëruar me dy nënpyetje a) për çfarë arsye dhe b) çfarë pozite ka pasur personi.








Rezultatet e exit-anketës kanë treguar që 97.04% e të anketuarve nuk u është kërkuar asnjëherë mito nga gjykatësit, punonjësit e gjykatës apo ndonjë ndërmjetësues që ka vepruar në emër të këtyre të fundit (1,316 nga 1,357). Në anën tjetër, më pak se 3% kanë deklaruar të kundërtën. Përqindja më e madhe e atyre që kanë pretenduar se u është kërkuar mito ka qenë në Gjykatën Themelore të Prishtinës (11.74%), pastaj në Gjykatën Themelore të Mitrovicës 3.66%), si dhe asaj të Gjilanit (2.74%).

**TABELA 35. A ju është kërkuar ndonjëherë ryshfet/mito nga ndonjë gjyqtar ose punonjës i gjykatës ose ndonjë ndërmjetësues në emër të tyre**

	Po	Jo
 Ferizaj	0.63%	99.37%
 Gjakovë	0.69%	99.31%
 Gjilan	2.74%	97.26%
 Mitrovicë	3.66%	96.34%
 Pejë	0.00%	100.00%
 Prishtinë	11.74%	88.26%
 Prizren	1.21%	98.79%

Siç mund të vërehet edhe në tabelën 36, atyre që janë përgjigjur pozitivisht në këtë pyetje, u është bërë edhe një pyetje shtesë me disa mundësi për t'u përgjigjur nga të cilat do të mund të zgjidhnin arsyet se pse ka ndodhur kjo: a) Për t'i përshpejtuar proceset; b) Për të marrë dokumentacionin e nevojshëm; c) që lënda të vendoset në favor timin; dhe d) tjetër. Të gjeturat tregojnë që shumicës së atyre që u është kërkuar mito ka qenë për shkak të nevojës për dokumente (10 raste) dhe për ta përshpejtuar procesin (13) raste. Numri më i madh i këtyre rasteve ka qenë në Gjykatën Themelore në Prishtinë (21 raste) dhe Gjykatën Themelore në Mitrovicë (2 raste).








**TABELA 36. Nëse po, për çfarë arsye<sup>8</sup>? (Pyetje me disa zgjidhje)**

		<b>Për t'i përshpejtuar proceset</b>	<b>Për të marrë dokumentacionin e nevojshëm</b>	<b>Që lënda të vendoset në favor timin</b>	<b>Tjetër</b>	<b>Totali</b>
	Ferizaj	0	0	0	0	<b>0</b>
	Gjakovë	0	0	0	0	<b>0</b>
	Gjilan	0	0	0	0	<b>0</b>
	Mitrovicë	0	2	0	0	<b>2</b>
	Pejë	0	0	0	0	<b>0</b>
	Prishtinë	10	11	0	0	<b>21</b>
	Prizren	0	0	0	0	<b>0</b>

8 SHËNIM: Të dhënat janë paraqitur në numra për shkak të numrit të vogël të përgjigjeve.

Për më shumë, të gjeturat e anketës tregojnë që 98.5% e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave nuk kanë ofruar mito për donjë gjykatës apo punonjës të gjykatës (1,326 nga 1,357 përdoruesë të shërbimeve). Pjesa e mbetur prej 3% të të anketuarve që janë përgjigjur pozitivisht në pyetjen nëse kanë ofruar mito për ndonjë gjykatës apo punonjës gjykatë kanë qenë në gjykatën në Prizren (4.24%), pastaj në Prishtinë (3.91%), Gjilan (1.37%), dhe Pejë (0.6%).








■ **TABELA 37. A i keni ofruar ndonjëherë ryshfet apo mito ndonjë gjykatësi ose punonjësi tjetër të gjykatës?**

	Po	Jo
 Ferizaj	0.00%	100.00%
 Gjakovë	0.00%	100.00%
 Gjilan	1.37%	98.63%
 Mitrovicë	0.00%	100.00%
 Pejë	0.60%	99.40%
 Prishtinë	3.91%	96.09%
 Prizren	4.24%	95.76%

Ata që janë përgjigjur pozitivisht janë pyetur edhe me disa nënpyetje shtesë, ku kanë pasur disa alternativa si përgjigje, duke përfshirë a) përshpejtimin e procesit; b) për të marrë dokumentet e nevojshme; c) për të vendosur rastin në favor timin; d) tjetër. Sipas të të gjeturave të anketës, 40% e të anketuarve që janë përgjigjur pozitivisht kanë thënë se kanë dhënë mito apo ryshfet për të vendosur rastin në favor të tyre, pastaj 35% kanë deklaruar se kanë dashur ta përshpejtojnë procesin dhe pjesa e mbetur kanë zgjedhur opsionin e marrjes së dokumenteve të nevojshme. Siç shihet në tabelën 39, vetëm një person është përgjigjur se ka paguar ryshfet për të vendosur drejtësi sa më shpejt që të jetë e mundur.

Të dhënat tregojnë që kur përdoruesit e shërbimeve të gjykatave kanë dhënë ryshfet, arsyeja kryesore për një gjë të tillë ka qenë që rasti të vendoset në favor të tyre, mirëpo atyre asnjëherë nuk u është kërkuar të japin ryshfet nga gjykatësit apo punonjësit e gjykatës ose palë të treta që kanë vepruar në emër të tyre. Dy arsyet kryesore pse u është kërkuar të paguajnë mito ka qenë nevoja për të marrë dokumente si dhe përshpejtimi i procesit në gjykatë.








■ **TABELA 38. Nëse po, për çfarë arsye? (Pyetje me disa alternativa)**

		<b>Për t'i përshpejtuar proceset</b>	<b>Për të marrë dokumentacionin e nevojshëm</b>	<b>Që lënda të vendoset në favor timin</b>	<b>Tjetër</b>	<b>Totali</b>
 <b>Ferizaj</b>		0	0	0	0	<b>0</b>
 <b>Gjakovë</b>		0	0	0	0	<b>0</b>
 <b>Gjilan</b>		0	1	1	0	<b>2</b>
 <b>Mitrovicë</b>		0	0	0	0	<b>0</b>
 <b>Pejë</b>		0	0	1	0	<b>1</b>
 <b>Prishtinë</b>		11	7	13	0	<b>31</b>
 <b>Prizren</b>		4	1	2	1	<b>8</b>

9 SHËNIM: Vetëm një numër i vogël i të anketuarve kanë pasur mundësi të përgjigjen në pyetjen përcjellëse, prandaj edhe numri i paraqitur është i vogël.

Për më shumë, përdoruesve të shërbimeve të gjykatës që kanë dhënë ryshfet, u janë bërë pyetje përcjellëse se kujt i kanë ofruar ryshfet, me opsione për të zgjedhur ndërmjet a) gjykatës; b) punonjës të gjykatës; dhe c) të tjerë. Pjesa më e madhe e të anketuarve kanë përzgjedhur opsion e punonjësve të gjykatës (17 nga 26 të anketuar), përcjellë nga gjykatësit (8 nga 26 të anketuar) dhe vetëm një ka përzgjedhur opsionin “tjetër”.

■ **TABELA 39. Nëse po, çfarë posti mban personi?**















	Gjykatës	Punonjës gjykatë	Tjetër	Totali
 Ferizaj	0	0	0	<b>0</b>
 Gjakovë	0	0	0	<b>0</b>
 Gjilan	1	1	0	<b>2</b>
 Mitrovicë	0	0	0	<b>0</b>
 Pejë	0	0	1	<b>1</b>
 Prishtinë	6	10	0	<b>16</b>
 Prizren	1	6	0	<b>7</b>

## Renditja e përgjithshme e gjykatave në raport me prevalencën e korrupsionit

Të gjitha gjykatat themelore janë renditur në nivelin nga një deri në shtatë sa i përket prevalencës së korrupsionit, ku një do të thotë që një gjykatë qëndron krahasimisht më mirë se të tjerat, ndërsa shtatë do të thotë se një gjykatë qëndron krahasimisht më dobët se gjykatat e tjera. Pikët për secilën gjykatë janë kalkuluar duke marrë për bazë mesataren e pikëve të dala nga numri i përgjigjeve pozitive dhe negative që kanë dhënë të anketuarit në listën e pyetjeve të bëra.

Prevalenca e korrupsionit është vlerësuar bazuar në pyetjet në vijim:

1. A ju është kërkuar ndonjëherë ryshfet/mito nga ndonjë gjyqtar ose punonjës i gjykatës ose ndonjë ndërmjetësues në emër të tyre?
2. Nëse po, për çfarë arsye?
3. A i keni ofruar ndonjëherë ryshfet një gjyqtari ose punonjësi tjetër të gjykatës?
4. Nëse po, për çfarë arsye?








Renditja	Gjykata Themelore
 <b>Vendi i parë</b>	 Pejë
 <b>Vendi i dytë</b>	 Ferizaj
 <b>Vendi i tretë</b>	 Gjakovë
 <b>Vendi i katërt</b>	 Gjilan
 <b>Vendi i pestë</b>	 Mitrovicë
 <b>Vendi i gjashtë</b>	 Prizren
 <b>Vendi i shtatë</b>	 Prishtinë

## Pyetje shtesë

Pyetjet shtesë përbëjnë pjesën e fundit të anketës me përdorues të shërbimeve të gjykatave e që përfshijnë një listë prej dhjetë pyetjesh që kanë për qëllim që ta vlerësojnë përdoruesit e shërbimeve në gjykatore gjatë seancave gjyqësore. Secila pyetje do të diskutohet detajisht më poshtë.








Së pari, përdoruesit e shërbimeve të gjykatave janë përgjigjur në disa pyetje me opsione, si për shembull në cilën pjesë të gjykatës kanë shkuar – e pastaj është dashur të zgjedhin ndërmjet gjashtë kategorive, duke përfshirë a) gjykatoren, b) zyrat e gjykatësve, c) zyrën e administratorit të gjykatës, d) zyrën për menaxhimin e rasteve, e) arkatarin / zyrën e financave, f) të tjera. Përgjigjet ndryshojnë nga gjykata në gjykatë, megjithatë, shumica e të anketuarve në të shtatë gjykatat deklaruan që shumicën e kohës kanë qenë në gjykatore, pastaj në zyra të gjykatësve dhe në zyrën për menaxhim të rasteve. Në anën tjetër, disa të anketuar në Gjilan (3.33 %) dhe Ferizaj (0.84%) kanë zgjedhur opsionin “tjetër” dhe kanë shpjeguar tutje që për zyret përkatëse kanë pyetur sigurimin, kanë kërkuar dokumente që nuk janë nën hetime apo kanë shkuar në zyrën e personelit.

■ **TABELA 40. Në cilën pjesë të ndërtesës së gjykatës keni shkuar? (Përgjigje me disa mundësi)**

		Gjykatore	Zyrat e gjyqtarëve	Zyra e administratorit të gjykatës	Zyra për menaxhimin e lëndëve	Arkatarin / Zyra e financave	Tjetër
	Ferizaj	35.02%	40.09%	2.95%	11.39%	9.71%	0.84%
	Gjakovë	42.22%	35.00%	8.33%	11.67%	2.78%	0.00%
	Gjilan	35.33%	49.33%	0.67%	10.67%	0.67%	3.33%
	Mitrovicë	28.80%	27.19%	17.15%	21.68%	5.18%	0.00%
	Pejë	24.02%	74.30%	0.56%	1.12%	0.00%	0.00%
	Prishtinë	48.99%	37.42%	5.20%	6.04%	2.35%	0.00%
	Prizren	28.51%	67.87%	1.36%	1.81%	0.45%	0.00%








Një tregues tjetër i rëndësishëm i drejtësisë procedurale ka të bëjë me atë se, a ndihen rehat përdoruesit e shërbimeve të gjykatave që të shkruajnë ankesa për gjykatën dhe t'i vendosin ato në kutinë për ankesa. Të dhënat e anketës tregojnë që rreth 80% e të anketuarve ndjehen rehat në shkrimin e ankesave dhe vendosjen e tyre në kuti të ankesave. Specifikisht, të dhënat tregojnë që 76% deri 95% e të anketuarve në secilën nga gjykatat themelore janë përgjigjur pozitivisht, përpos në rastin e Gjakovës. Pjesa më e madhe e të anketuarve që nuk ndjehen rehat me shkrimin e ankesave dhe vendosjen e tyre në kutinë e ankesave kanë qenë ata në Gjakovë (63.89%).

**TABELA 41. A do të ndiheshit rehat t'i shkruanit ankesat tuaja për gjykatën dhe të njëjtat t'i vendosnit në kutinë e ankesave?**








	Po	Jo
 <b>Ferizaj</b>	94.30%	5.70%
 <b>Gjakovë</b>	36.11%	63.89%
 <b>Gjilan</b>	95.21%	4.79%
 <b>Mitrovicë</b>	76.83%	23.17%
 <b>Pejë</b>	89.76%	10.24%
 <b>Prishtinë</b>	79.95%	20.05%
 <b>Prizren</b>	92.12%	7.88%

Më tutje, të dhënat janë ndarë për të parë nëse një gjini ndjehet më pak ose më rehat se sa gjinia tjetër në shkrimin dhe vendosjen e ankesave në kuti. Të dhënat tregojnë që një përqindje më e lartë, edhe pse jo e konsiderueshme, janë përgjigjur negativisht. Siç shihet në dy tabelat më poshtë 81% (907 nga 1,111) e burrave kundrejt 77% (187 kundrejt 241) e grave janë përgjigjur pozitivisht, ndërsa 18% (204 nga 1,111) e burrave kundrejt 22% (54 nga 241) e grave janë përgjigjur negativisht.

**TABELA 42.** A do të ndiheshit rehat t'i shkruanit ankesat tuaja për gjykatën dhe të njëjtat t'i vendosnit në kutinë e ankesave? (Vetëm burra)








	Po	Jo
 Ferizaj	95.24%	4.76%
 Gjakovë	36.89%	63.11%
 Gjilan	93.64%	6.36%
 Mitrovicë	78.32%	21.68%
 Pejë	89.03%	10.97%
 Prishtinë	80.47%	19.53%
 Prizren	91.60%	8.40%

**TABELA 43.** A do të ndiheshit rehat t'i shkruanit ankesat tuaja për gjykatën dhe të njëjtat t'i vendosnit në kutinë e ankesave? (Vetëm gra)

	Po	Jo
 Ferizaj	90.62%	9.38%
 Gjakovë	34.15%	65.85%
 Gjilan	100.00%	0.00%
 Mitrovicë	66.67%	33.33%
 Pejë	100.00%	0.00%
 Prishtinë	77.27%	22.73%
 Prizren	94.12%	5.88%








Për më shumë, të anketuarit janë pyetur nëse kanë folur me dikë në këndin e informacionit. Pjesa më e madhe e të anketuarve janë përgjigjur pozitivisht duke filluar me Gjilanin (97.26%), pastaj Ferizaj (93.04%), Prizreni (89.7%), Peja (85.54%), Gjakova (76.39%), Prishtina (61.37%), Mitrovica (54.88%). Në anën tjetër, rreth 20% janë përgjigjur negativisht, ku prinë Gjakata Themelore e Mitrovicës (45.12%), pastaj Prishtina (38.61%) dhe Gjakova 23.61%.

■ TABELA 44. A keni biseduar me dikë te këndi i informimit?

	Po	Jo
 Ferizaj	93.04%	6.96%
 Gjakovë	76.39%	23.61%
 Gjilan	97.26%	2.74%
 Mitrovicë	54.88%	45.12%
 Pejë	85.54%	14.46%
 Prishtinë	61.37%	38.63%
 Prizren	89.70%	10.30%








Të dhënat tregojnë që, jo të gjithë përdoruesit e shërbimeve të gjykatave që kanë folur me dikë në këndin e informacionit, kanë gjetur ndihmë. Siç shihet në tabelën më poshtë, pjesa më e madhe e të anketuarve ku janë ndihmuar më së shumti ka qenë në Prizren (92.57%) dhe Pejë (90.14%). Në anën tjetër, pjesa më e madhe e të anketuarve, ku personi në këndin e informacionit *nuk ka ndihmuar aspak* ka qenë ajo në Mitrovicë (43.9%).

■ **TABELA 45. Sa ju ka ndihmuar personi përgjegjës në këndin e informimit?**

		<b>Më ka ndihmuar shumë</b>	<b>Më ka ndihmuar deri diku</b>	<b>Nuk më ka ndihmuar shumë</b>	<b>Nuk më ka ndihmuar aspak</b>
	<b>Ferizaj</b>	73.47%	25.85%	0.68%	0.00%
	<b>Gjakovë</b>	70.00%	24.54%	3.64%	1.82%
	<b>Gjilan</b>	85.21%	14.79%	0.00%	0.00%
	<b>Mitrovicë</b>	53.05%	1.22%	1.83%	43.90%
	<b>Pejë</b>	90.14%	4.23%	2.11%	3.52%
	<b>Prishtinë</b>	60.16%	31.47%	8.37%	0.00%
	<b>Prizren</b>	92.57%	4.05%	2.70%	0.68%








Tutje, të anketuarit kanë mundur të zgjedhin ndërmjet të katër niveleve, duke përfshirë a) pajtohem plotësisht; b) pajtohem; c) nuk pajtohem; dhe d) nuk pajtohem aspak, kur janë pyetur nëse shenjat dhe informacioni për të kuptuar procedurat e sigurisë në hyrje të ndërtesës dhe nëse personeli i sigurimit kanë ndihmuar dhe kanë treguar respekt. Në pyetjen e parë, të gjeturat e anketës tregojnë që një përqindje e lartë e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave që kanë deklaruar *pajtohem plotësisht* dhe *pajtohem* kanë qenë në Pejë (79.52% dhe 13.85% respektivisht), pastaj në Ferizaj (26.58% dhe 70.89%). Në anën tjetër, pjesa më e madhe e atyre që kanë deklaruar se *nuk pajtohem aspak* dhe *nuk pajtohem* kanë qenë në Mitrovicë (15.24% dhe 4.27% respektivisht).

■ **TABELA 4.6.** Kishte mjaftueshëm shenja dhe informata për t'i kuptuar procedurat e sigurisë për të hyrë në ndërtesë dhe a ishte personeli i sigurimit i dobishëm dhe i respektueshëm.

		<b>Pajtohem plotësisht</b>	<b>Pajtohem</b>	<b>Nuk pajtohem</b>	<b>Nuk pajtohem aspak</b>
	<b>Ferizaj</b>	26.58%	70.89%	1.90%	0.63%
	<b>Gjakovë</b>	61.81%	34.72%	3.47%	0.00%
	<b>Gjilan</b>	54.11%	43.15%	2.74%	0.00%
	<b>Mitrovicë</b>	5.49%	75.00%	15.24%	4.27%
	<b>Pejë</b>	79.52%	13.85%	4.82%	1.81%
	<b>Prishtinë</b>	35.21%	63.81%	0.73%	0.25%
	<b>Prizren</b>	29.09%	65.45%	4.85%	0.61%

Tutje, përdoruesit e shërbimeve të gjykatave që janë pajtuar plotësisht me deklaratën se personeli i sigurimit kanë ndihmuar dhe kanë treguar respekt, kanë përbërë pjesën kryesore të përgjigjeve. Në anën tjetër, ata që kanë deklaruar se nuk pajtohem aspak dhe nuk pajtohem kanë përbërë përqindjen më të vogël e të papërfillshme krahasuar me ata që kanë deklaruar se personeli ka ndihmuar dhe treguar respekt.

■ TABELA 47. Personeli i sigurimit ka ndihmuar dhe ka qenë i respektueshëm

	Pajtohem plotësisht	Pajtohem	Nuk pajtohem	Nuk pajtohem aspak
 Ferizaj	16.46%	83.54%	0.00%	0.00%
 Gjakovë	70.83%	25.70%	2.08%	1.39%
 Gjilan	54.79%	45.21%	0.00%	0.00%
 Mitrovicë	64.02%	35.37%	0.61%	0.00%
 Pejë	83.73%	12.05%	2.41%	1.81%
 Prishtinë	56.97%	42.79%	0.24%	0.00%
 Prizren	88.48%	11.52%	0.00%	0.00%

Siç shihet në dy tabelat më poshtë, ndarja sipas gjinisë tregon që shumica kryesore e burrave dhe grave pajtohen plotësisht dhe pajtohen që personeli i sigurimit ka ndihmuar dhe ka treguar respekt.

**TABELA 48.** Personeli i sigurimit ka ndihmuar dhe ka qenë i respektueshëm. (Vetëm burra)



		<b>Pajtohem plotësisht</b>	<b>Pajtohem</b>	<b>Nuk pajtohem</b>	<b>Nuk pajtohem aspak</b>
	Ferizaj	16.67%	83.33%	0.00%	0.00%
	Gjakovë	71.85%	24.27%	2.91%	0.97%
	Gjilan	53.64%	46.36%	0.00%	0.00%
	Mitrovicë	64.34%	34.96%	0.70%	0.00%
	Pejë	83.23%	12.90%	2.58%	1.29%
	Prishtinë	56.56%	43.15%	0.29%	0.00%
	Prizren	88.55%	11.45%	0.00%	0.00%








**TABELA 49.** Personeli i sigurimit ka ndihmuar dhe ka qenë i respektueshëm. (Vetëm gra)



		<b>Pajtohem plotësisht</b>	<b>Pajtohem</b>	<b>Nuk pajtohem</b>	<b>Nuk pajtohem aspak</b>
	Ferizaj	15.62%	84.38%	0.00%	0.00%
	Gjakovë	68.29%	29.27%	0.00%	2.44%
	Gjilan	58.33%	41.67%	0.00%	0.00%
	Mitrovicë	61.90%	38.10%	0.00%	0.00%
	Pejë	90.91%	0.00%	0.00%	9.09%
	Prishtinë	59.09%	40.91%	0.00%	0.00%
	Prizren	88.24%	11.76%	0.00%	0.00%








Shumica dërmuese e të anketuarve janë pajtuar (53%) dhe janë pajtuar plotësisht (40%) që ndërtesa ka qenë e pastër dhe e mirëmbajtur. Në anën tjetër, përqindja e atyre që deklaruan që nuk pajtohen aspak (1.11%) ishte e papërfillshme dhe ishte shpërndarë ndërmjet përdoruesve të shërbimeve në Gjykatën Themelore të Mitrovicës dhe të Pejës.

■ TABELA 50. Ndërtesa ishte e pastër dhe e mirëmbajtur

		Pajtohem plotësisht	Pajtohem	Nuk pajtohem	Nuk pajtohem aspak
	Ferizaj	13.93%	85.44%	0.63%	0.00%
	Gjakovë	64.58%	34.03%	1.39%	0.00%
	Gjilan	47.26%	50.69%	2.05%	0.00%
	Mitrovicë	12.81%	70.12%	13.41%	3.66%
	Pejë	79.52%	13.25%	4.22%	3.01%
	Prishtinë	31.78%	55.50%	12.23%	0.49%
	Prizren	30.30%	64.85%	4.24%	0.61%








Për më shumë, pjesa më e madhe e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave nëpër të shtatë gjykatat themelore pajtohen plotësisht (40%) dhe pajtohen (51%) që shenjat e vendosura përreth ndërtesave dhe brenda gjykatores ishin të dukshme dhe lehtësisht të kuptueshme.

■ **TABELA 51. Shenjat e vendosura përreth ndërtesës dhe brenda gjykatores ishin të dukshme dhe lehtësisht të kuptueshme**

		<b>Pajtohem plotësisht</b>	<b>Pajtohem</b>	<b>Nuk pajtohem</b>	<b>Nuk pajtohem aspak</b>
	<b>Ferizaj</b>	9.49%	80.38%	10.13%	0.00%
	<b>Gjakovë</b>	68.06%	27.08%	3.47%	1.39%
	<b>Gjilan</b>	49.31%	46.58%	4.11%	0.00%
	<b>Mitrovicë</b>	18.29%	62.81%	13.41%	5.49%
	<b>Pejë</b>	77.71%	10.24%	7.23%	4.82%
	<b>Prishtinë</b>	38.14%	60.88%	0.73%	0.25%
	<b>Prizren</b>	24.24%	72.73%	2.42%	0.61%

Për më shumë, 96% e të anketuarve siç shihet në tabelën më poshtë janë përgjigjur pozitivisht nëse shenjat e vendosura nëpër ndërtesë dhe brenda gjykatores kanë qenë në gjuhën e tyre amtare.








■ **TABELA 52. Shenjat e vendosura përreth ndërtesës dhe brenda gjykatores ishin në gjuhën time amtare**

	Po	Jo
 Ferizaj	92.41%	7.59%
 Gjakovë	95.83%	4.17%
 Gjilan	95.21%	4.79%
 Mitrovicë	99.39%	0.61%
 Pejë	97.59%	2.41%
 Prishtinë	99.76%	0.24%
 Prizren	94.55%	5.45%

Tutje, të anketuarit janë përgjigjur përmes disa opsioneve ku kishin mundësi të zgjidhnin ndërmjet të disa kategorive në pyetjen se që në momentin që kur ka nisur rasti i tyre është dashur a) të mungojnë në punë për të marrë pjesë në një seancë dëgjimore ose për të kryer punë në gjykatë; b) kanë ardhur në gjykatë dhe janë ndjerë sikur nuk ka pasur asnjë përparim me lëndën e tyre; c) Ka ndikuar në aftësinë e tyre për të gjetur punë/për t'u licencuar/për t'u certifikuar; d) nuk kanë arritur të aplikojnë për vizë; f) është dashur të ndryshojnë avokatin / përfaqësuesin ligjor, e) nuk kanë pasur avokat dhe është dashur të përfaqësojnë vetveten. Është e rëndësishme të ceket që të anketuarit kanë pasur mundësi të zgjedhin një, më shumë apo të gjitha kategoritë e përmendura.








Të gjeturat e anketës kanë treguar që, shumica e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave kanë a) munguar në punë për të marrë pjesë në një seancë dëgjimore ose për të kryer punë në gjykatë (49%), pastaj b) kanë ardhur në gjykatë dhe janë ndjerë sikur nuk ka pasur asnjë përparim me lëndën e tyre (24%), dhe c) nuk kanë pasur avokat dhe është dashur të përfaqësojnë vetveten (16%).

**TABELA 53.** Në momentin që kur ka filluar të shqyrtohet lënda juaj, a ka ndodhur ndonjëra nga të mëposhtmet. (Pyetje me disa përgjigje)

	Kam munguar në punë për të marrë pjesë në një seancë dëgjimore ose për të kryer punë në gjykatë	Kam ardhur në gjykatë dhe jam ndjerë sikur nuk ka pasur asnjë përparim me lëndën time.	Ka ndikuar në aftësinë time për të gjetur punë/për t'u licencuar/për t'u certifikuar	Më është pamundësuar aplikimi për vizë	Më është dashur të ndërroj avokatin/përfaqësuesin ligjor	Nuk kam pasur avokat dhe më është dashur të përfaqësoj veten
 <b>Ferizaj</b>	57.52%	3.98%	2.66%	7.52%	11.95%	16.37%
 <b>Gjakovë</b>	32.83%	18.41%	2.49%	10.45%	5.47%	30.35%
 <b>Gjilan</b>	54.66%	28.67%	2.00%	4.00%	2.00%	8.67%
 <b>Mitrovicë</b>	23.55%	25.21%	2.89%	2.07%	0.83%	45.45%
 <b>Pejë</b>	76.99%	13.14%	2.82%	2.35%	3.29%	1.41%
 <b>Prishtinë</b>	39.36%	57.26%	0.60%	0.40%	1.59%	0.79%
 <b>Prizren</b>	58.87%	21.77%	1.21%	3.23%	1.21%	13.71%

Për më shumë, të anketuarit ishin pyetur nëse u është dashur të rikthehen për një seancë tjetër dëgjimore dhe a janë pyetur se çfarë date do të ishte më e përshtatshme për ta?– dhe nga 80% e tyre që u ishte dashur të riktheheshin në gjykatë, 37% thanë që ishin pyetur për ditën që ju përshtatet. Në anën tjetër, pjesa më e madhe ishin përgjigjur negativisht (62%).








■ **TABELA 54. A ju është dashur të riktheheni për një seancë tjetër dëgjimore, a ju ka pyetur ndokush se çfarë date do të ishte më e përshtatshme për ju?**

		<b>Po</b>	<b>Jo</b>	<b>Totali</b>
	<b>Ferizaj</b>	29	40	<b>69</b>
	<b>Gjakovë</b>	60	33	<b>93</b>
	<b>Gjilan</b>	103	30	<b>133</b>
	<b>Mitrovicë</b>	64	50	<b>114</b>
	<b>Pejë</b>	4	120	<b>124</b>
	<b>Prishtinë</b>	132	264	<b>396</b>
	<b>Prizren</b>	19	143	<b>162</b>








Trajtimi i paanshëm është një element tjetër i rëndësishëm i drejtësisë procedurale, prandaj, përdoruesit e shërbimeve të gjykatave ishin pyetur nëse ishin trajtuar ndryshe dhe nëse kanë pasur mundësi të zgjedhin ndërmjet shtatë kategorive 1) raca/përkatësia; 2) gjuha që flas; 3) gjinia; 4) statusi ekonomik; 5) pamja; 6) mosha; dhe 7) diçka tjetër.

Të dhënat e anketës tregojnë që, pjesa më e madhe e të anketuarve kishin përzgjedhë kategorinë diçka tjetër (49%), pastaj statusin ekonomik (25%), dhe gjuhën që flasin (15.47). Është e rëndësishme të ceket që gjinia është përmendur si arsye për trajtim ndryshe në më pak se 2% të rasteve.

**TABELA 55. Nëse jeni trajtuar ndryshe prej palëve të tjera, pse mendoni se jeni trajtuar ndryshe? (Pyetje me disa përgjigje)**

	Raca/Etnia ime	Gjuha që unë flas	Gjinia ime	Statusi im ekonomik	Pamja ime (veshja, flokët, etj.)	Mosha ime	Diçka tjetër
 Ferizaj	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	7.69%	15.39%	76.92%
 Gjakovë	7.69%	0.00%	3.85%	11.54%	26.92%	34.62%	15.38%
 Gjilan	0.00%	0.00%	4.08%	14.29%	4.76%	4.08%	72.79%
 Mitrovicë	3.21%	14.22%	2.75%	20.18%	10.55%	5.51%	43.58%
 Pejë	0.00%	0.00%	0.00%	100.00%	0.00%	0.00%	0.00%
 Prishtinë	0.62%	0.42%	3.11%	27.18%	15.35%	4.56%	48.76%
 Prizren	1.65%	0.83%	0.00%	4.13%	0.83%	0.83%	91.73%








Ata që u përgjigjën me diçka tjetër, ju kërkua që të identifikojnë arsyen për trajtim ndryshe. Tabela e mëposhtme tregon që përgjigjia më e shpesht ishte mungesa e lidhjeve familjare/miqësore/politike me ndokënd që punon në gjykatë.

Numri i komenteve	Komente
 5	Nuk kam lidhje familjare/miqësore/politike me stafin e gjykatës
 1	Kam dhënë para, prandaj jam trajtuar ndryshe
 1	Jam person me nevoja të veçanta
 1	Nuk i kam dhënë para askujt në gjykatë
 1	Jam trajtuar ndryshe për shkak të lëndës sime
 1	Jam trajtuar ndryshe për shkak që jam e/i pafajshëm/me
 1	Lidhjet politike

■ TABELA 56. Përgjigjet nga të gjitha gjykatat themelore janë kategorizuar nga autorja

Për më shumë, përdoruesit e shërbimeve të gjykatave janë pyetur nëse kanë pasur mundësi që të parashtronin pyetje ditën e vizitës në gjykatë. Rezultatet e anketës tregojnë që 52.59% janë përgjigjur pozitivisht, 28% e të anketuarve nuk e kanë pasur ndjenjën se mund të parashtronin pyetje dhe rreth 19% nuk kanë menduar se kane nevojë të parashtronin pyetje. Edhe pse mbi gjysma e të anketuarve mendojnë se kanë mundësi të parashtronin pyetje, 1/3 e të anketuarve tjerë nuk kanë menduar se kishin mundësinë të parashtronin pyetje, e që është një sfidë për drejtësinë procedurale. Përqindja më e madhe e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave që janë përgjigjur negativisht ishin në Pejë (36.14%), në Prizren (34.55%) dhe Prishtinë (26.89%).

**TABELA 57. Në përgjithësi, a mendoni se keni patur mundësinë t'i parashtroni pyetjet, përgjigjet e të cilave ju nevojiteshin sot?**















	Po	Jo	Nuk aplikohet
 Ferizaj	22.15%	0.63%	77.22%
 Gjakovë	52.78%	20.14%	27.08%
 Gjilan	17.81%	6.16%	76.03%
 Mitrovicë	90.24%	9.76%	0.00%
 Pejë	62.65%	36.14%	1.21%
 Prishtinë	65.53%	26.89%	7.58%
 Prizren	56.97%	34.55%	8.48%

## Renditja e përgjithshme e gjykatave përkitazi me pyetjet shtesë

Të gjitha gjykatat themelore janë renditur në nivelin nga një deri në shtatë sa i përket pyetjeve shtesë, ku një do të thotë që një gjykatë qëndron krahasimisht më mirë se të tjerat, ndërsa shtatë do të thotë se një gjykatë qëndron krahasimisht më dobët se gjykatat e tjera. Pikët për secilën gjykatë janë kalkuluar duke marrë për bazë mesataren e pikëve të dala nga numri i përgjigjeve pozitive dhe negative që kanë dhënë të anketuarit në listën e pyetjeve të bëra.









Pyetjet e tjera të përfshira:

1. A do të ndiheshit rehat t'i shkruanit ankesat tuaja për gjykatën dhe të njëjtat t'i vendosnit në rutinë e ankesave?
2. A keni biseduar me dikë te këndi i informimit?
3. Sa ju ka ndihmuar personi përgjegjës në këndin e informimit?
4. Kishte mjaftueshëm shenja dhe informata për t'i kuptuar procedurat e sigurisë për të hyrë në ndërtesë?
5. Personeli i sigurimit kanë qenë i dobishëm dhe i respektueshëm.
6. Ndërtesa ishte e pastër dhe e mirëmbajtur.
7. Shenjat e vendosura përreth ndërtesës dhe brenda gjykatores ishin të dukshme dhe lehtësisht të kuptueshme.
8. Shenjat e vendosura përreth ndërtesës dhe brenda gjykatores ishin në gjuhën time amtare.
9. Në momentin që ka filluar të shqyrtohet lënda juaj, a ka ndodhur ndonjëra nga të mëposhtmet?
10. Nëse ju është dashur të riktheheni për një seancë tjetër dëgjimore, a ju ka pyetur ndokush se çfarë date do të ishte më e përshtatshme për ju?
11. Nëse jeni trajtuar ndryshe prej palëve të tjera, pse mendoni se jeni trajtuar ndryshe?

Renditja	Gjykata Themelore
 <b>Vendi i parë</b>	 Gjakovë
 <b>Vendi i dytë</b>	 Pejë
 <b>Vendi i tretë</b>	 Prizren
 <b>Vendi i katërt</b>	 Ferizaj
 <b>Vendi i pestë</b>	 Gjilan
 <b>Vendi i gjashtë</b>	 Prishtinë
 <b>Vendi i shtatë</b>	 Mitrovicë

Në fund, të anketuarit janë pyetur nëse kishin ndonjë gjë për të shtuar rreth përvojës së tyre pozitive apo negative.

Të dhënat e anketës tregojnë që përgjigjet janë të shumta, por që të gjitha ndërlidhen me performancë më të mirë të gjykatave. Tabela më poshtë tregon këto komente të grupuara në tetë kategori:

Numri i komenteve	Komentet
 26	Nuk po punohet mjaftueshëm; efikasitet i ulët i gjykatave; puna duhet të përmirësohet.
 23	Jashtzakonisht i/e palumtur dhe zhgënjyer me punën e gjykatës, me vonesat e lëndëve dhe vonesat e gjykatësve. Njerëz të papërgjegjshëm dhe të paedukuar punojnë nëpër gjykata.
 5	Unë nuk mund të komunikoj në gjuhën time amtare (shqip); U detyrova të flas në gjuhë angleze me stafin e gjykatës ngase ata nuk flisnin shqip, u desh të flas në gjuhën serbe sepse ata nuk flisnin shqip.
 4	Kam vonesa në udhëtim për shkak të disa dokumenteve që kërkohen nga gjykata, prandaj shpresoj që asnjë rrugë nuk do të më sjellë më në këtë gjykatë; udhëtimi në Gjermani është shtyrë e po ashtu aplikimi për vizë; unë nuk mund të aplikoj për punë pa marrë dokumentet këtu.
 1	Një ndërtesë më e mirë dhe me hapësirë më të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara.
 1	Unë jam i papunë, prandaj më është caktuar një avokat për të më përfaqësuar në gjykatë, por avokati nuk ka dashur të më përfaqësojë, prandaj ma kanë ndryshuar përsëri avokatin, ky është një sistem i shtrembër.
 1	Shpresoj që rasti im do të zgjidhet sa më shpejt, ngase më është dashur të marrë ditë të lira në punë.
 20	Jam i lumtur që puna ime ka përfunduar shpejt; stafi, duke përfshirë edhe sigurimin kanë qenë të dobishëm; gjykatësit kanë qenë të dobishëm dhe kanë treguar respekt.

■ TABELA 58. Përgjigjet nga të gjitha gjykatat themelore janë grupuar në tetë kategori nga autorja

Komente të ngjashme lidhur me efikasitetin e gjykatave dhe aspekte të tjera (siç u paraqitën më lart) u bënë për shtatë gjykatat themelore, për problemin e gjuhës që është më i pranishëm vetëm në Gjykatën Themelore në Mitrovicë (ndërtesën në jug). Të dhënat nga Mitrovica tregojnë që përdoruesit e gjykatave hasin në vështirësi që të komunikojnë në gjuhë amtare me stafin e gjykatës (gjuhën shqipe). Edhe pse numri i të anketuarve që pretendojnë se kanë hasur në vështirësi që të komunikojnë në gjuhë amtare (shqip) me stafin e gjykatës nuk është i lartë, megjithatë paraqet një sfidë që duhet marrë parasysh, duke qenë se gjuha është një element kyç që ndikon në perceptimet e besimit në gjykata.

## Krahasimi i renditjes ndërmjet gjykatave themelore (2018- 2021)

Të gjitha gjykatat themelore janë renditur në nivelin nga një deri në shtatë sa i përket a) qasjes në informacion dhe transparencë; b) paanshmërinë dhe efikasitetin; c) prevalencën e korrupsionit, ku një do të thotë që një gjykatë qëndron krahasimisht më mirë se të tjerat, ndërsa shtatë do të thotë se një gjykatë qëndron krahasimisht më dobët se gjykatat e tjera. Pikët për secilën gjykatë janë kalkuluar duke marrë për bazë mesataren e pikëve të dala nga numri i përgjigjeve pozitive dhe negative që kanë dhënë të anketuarit në listën e pyetjeve të bëra.

Qasja në informacion dhe transparenca janë vlerësuar duke marrë për bazë pyetjet si në vijim:

1. Sipas përvojës suaj, sa e lehtë është qasja në informacion rreth rastit tuaj?
2. Sa ju kanë ndihmuar informacionet që ua ka dhënë gjykata?
3. Cila ka qenë përvoja juaj në gjetjen e gjykatores apo zyrës që u është nevojitur?
4. A janë të qasshme kutitë e ankesave nëpër gjykata?
5. A ka gjykata kënd informativ?
6. A e përdorni ueb faqen e gjykatës për të marrë informacion?
7. Çfarë informatash kërkon kryesisht në ueb-faqe të gjykatës?
8. A është përmbajtja e ueb faqes së komunës e përkthyer në gjuhën tuaj amtare?
9. A jeni të kënaqur me kualitetin e përkthimit të përmbajtjes që gjendet në ueb-faqe?

Efikasiteti dhe paanshmëria janë vlerësuar duke përdorur pyetjet si në vijim:

11. A keni kryer punë në gjykatë brenda një kohe të arsyeshme sot?
12. Qe sa kohë është e hapur lënda juaj?
13. A jeni të kënaqur me kohën që po merr shqyrtimi i lëndës suaj?
14. A jeni trajtuar me mirësjellje dhe respekt nga personeli i gjykatës?
15. A vlerësoni që jeni trajtuar fer nga gjykatësit?
16. A ju është dhënë mundësia që të flisni në gjuhën tuaj amtare me personelin e gjykatës?
17. A ka ofruar gjykata përkthim gjatë seancave?
18. A jeni të kënaqur me kualitetin e përkthimit gjatë seancave?
19. A i pranoni/merrni dokumentet nga gjykata në gjuhën tuaj amtare?
20. A ndjeheni (fizikisht) të sigurtë në objektin e gjykatës?
21. A e dini se ju mund të parashtroni ankesa për shkelje disiplinore të gjykatësve?

Prevalenca e korrupsionit është vlerësuar përmes pyetjeve si në vijim:

22. A ju është kërkuar ndonjëherë ryshfet/mito nga ndonjë gjyqtar ose punonjës i gjykatës ose ndonjë ndërmjetësues në emër të tyre?
23. Nëse po, për çfarë arsye?
24. A i keni ofruar ndonjëherë ryshfet një gjyqtari ose punonjësi tjetër të gjykatës?
25. Nëse po, për çfarë arsye?

Pyetjet shtesë janë vlerësuar përmes pyetjeve si në vijim:

26. A do të ndiheshit rehat t'i shkruanit ankesat tuaja për gjykatën dhe të njëjtat t'i vendosnit në kutinë e ankesave?
27. A keni biseduar me dikë të këndi i informimit?
28. Sa ju ka ndihmuar personi përgjegjës në këndin e informimit?
29. Kishte mjaftueshëm shenja dhe informata për t'i kuptuar procedurat e sigurisë për të hyrë në ndërtesë?
30. Personeli i sigurimit ka qenë i dobishëm dhe ka treguar respekt.
31. Ndërtesa ishte e pastër dhe e mirëmbajtur.
32. Shenjat e vendosura përreth ndërtesës dhe brenda gjykatores ishin të dukshme dhe lehtësisht të kuptueshme.

33. Shenjat e vendosura përreth ndërtesës dhe brenda gjykatores ishin në gjuhën time amtare.
34. Që kur ka filluar të shqyrtohet lënda juaj, a ka ndodhur ndonjëra nga të mëposhtmet?
35. Nëse ju është dashur të riktheheni për një seancë tjetër dëgjimore, a ju ka pyetur ndokush se çfarë date do të ishte më e përshtatshme për ju?
36. Nëse jeni trajtuar ndryshe prej palëve të tjera, pse mendoni se jeni trajtuar ndryshe?

## Shënim:

Kanë qenë disa pyetje për të cilat është dashur të ndryshohet renditja e përgjigjeve, meqenëse në mënyrën siç ishin formuluar pyetjet, pikët më të larta tregonin performancë më të ulët në disa sektorë.








Për disa pyetje, ishte e nevojshme që përgjigjet të fshihen, në rast kur përgjigjet nuk i kontribuonin prevalencës apo mungesës së çështjes së vlerësuar.

Ka pasur disa pyetje për të cilat pjesëmarrësve u është kërkuar të zgjedhin disa opsione paralelisht. Në këto raste, pikët pozitive të çështjes së vlerësuar ishin më të larta kur të anketuarit zgjedhën më shumë përgjigje dhe më i ulët kur të anketuarit zgjedhën vetëm disa opsione/përgjigje.








Për sektorin e “Prevalencës së korrupsionit”, vendet e para janë zënë nga gjykatat themelore me numrin më të vogël të rasteve të raportuara të ndodhjes së korrupsionit, përderisa vendet e fundit janë gjykatat ku të anketuarit kanë raportuar ndodhjen e korrupsionit.

■ Krahasimi i renditjes së të gjitha gjykatave në qasjen në informacion dhe transparencë për periudhën 2018-2021








**Krahasimi i renditjes së të gjitha gjykatave në qasjen në informacion dhe transparencë**

	2018	↑↓	2020	↑↓	2021
 Ferizaj	1	—	1	↓	7
 Gjakovë	4	↑	2	↓	5
 Gjilan	2	↓	3	↑	2
 Mitrovicë	6	↑	5	↑	1
 Pejë	3	↓	4	↓	6
 Prishtinë	7	↑	6	↑	3
 Prizren	5	↓	7	↑	4

■ Krahasimi i renditjes së të gjitha gjykatave rreth efikasitetit dhe paanshmërisë për periudhën 2018-2021

Krahasimi i renditjes së të gjitha gjykatave rreth efikasitetit dhe paanshmërisë		2018	↑↓	2020	↑↓	2021
	Ferizaj	1	↓	3	↑	2
	Gjakovë	6	↑	5	↑	4
	Gjilan	3	↓	4	↑	3
	Mitrovicë	7	↑	2	↑	1
	Pejë	2	↑	1	↓	5
	Prishtinë	5	↓	7	—	7
	Prizren	4	↓	6	—	6

■ Krahasimi i renditjes së të gjitha gjykatave rreth prevalencës së korrupsionit për periudhën 2018-2021

Krahasimi i renditjes së të gjitha gjykatave rreth prevalencës së korrupsionit	2018	↑↓	2020	↑↓	2021
 Ferizaj	2	↑	1	↓	2
 Gjakovë <sup>10</sup>	1	—	1	↓	3
 Gjilan	4	↓	5	↑	4
 Mitrovicë	5	↑	4	↓	5
 Pejë	1	↓	2	↑	1
 Prishtinë	3	—	3	↓	7
 Prizren	6	—	6	—	6

10 Në raportin e Vlerësimit të Qytetarëve për Shërbimet e Gjykatave Themelore të vitit 2018, dy gjykata janë renditur të parat sa i përket prevalencës së korrupsionit, prandaj renditja ka vazhduar nga numri tre e tutje, përderisa nuk ka pasur vend të dytë. Për qëllime të krahasimit, tabela për vitin 2018 është ndryshuar për të reflektuar logjikën e renditjes në vitin 2020. Megjithatë, kjo nuk e ndryshon renditjen e gjykatave themelore për vitin 2018.












# REZULTATET E ANKETËS NGA VËZHGIMI NË GJYKATORE

# Rezultatet e anketës nga vëzhgimi në gjykatore

Anketa nga vëzhgimi në gjykatore ka përfshirë 18 pyetje dhe shtatë pyetje përcjellëse për të ofruar informacione më të detajuara. Në kapitullin në vijim do të interpretohen rezultatet e pyetjeve observuese siç janë renditur në anketë.








Dimensioni i parë që është vëzhguar ka qenë nëse është ofruar përkthimi gjatë seancave gjyqësore. Rezultatet e vëzhgimit në gjykatore tregojnë që, në 97.49% të seancave gjyqësore ku përkthimi ka qenë i nevojshëm, është ofruar. Në vetëm 2.57% të seancave gjyqësore nuk ka pasur përkthim edhe pse ka qenë një nevojë e tillë. Këtu prinë Gjykata Themelore e Pejës me 1.59%, pastaj e Mitrovicës me 0.98%, e seancave ku përkthimi nuk është ofruar, përderisa Gjykata Themelore e Mitrovicës ka pasur përqindjen më të lartë të seancave ku është nevojitur përkthimi.

■ TABELA 59. A është siguruar përkthimi gjatë seancës?

	Po	Jo	Nuk aplikohet
 Ferizaj	0.97%	0.00%	99.03%
 Gjakovë	0.00%	0.00%	100.00%
 Gjilan	79.4%	0.00%	92.06%
 Mitrovicë	69.61%	0.98%	29.41%
 Pejë	6.35%	1.59%	92.06%
 Prishtinë	6.17%	0.00%	93.83%
 Prizren	6.45%	0.00%	93.55%

Për më shumë, siç mund të shihet në tabelën në vijim, seancat ku është kërkuar përkthimi dhe është siguruar përkthimi në gjuhën shqipe (74 raste), gjuhën serbe (72 raste), gjuhën boshnjake (6 raste) dhe gjuhën turke (1 rast). Gjykata Themelore në Mitrovicë prinë në aspekt të numrit të seancave ku ka qenë i nevojshëm përkthimi (127), pastaj Gjilani (10 raste) dhe Prizreni (7 raste).








■ TABELA 60. Përkthimi i siguruar<sup>11</sup>

		Gjuhë shqipe	Gjuhë serbe	Gjuhë boshnjake	Gjuhë turke	Gjuhë rome	Gjuhë gorane	Tjetër	Totali
	Ferizaj	0	1	0	0	0	0	0	<b>1</b>
	Gjakovë	0	0	0	0	0	0	0	<b>0</b>
	Gjilan	5	5	0	0	0	0	0	<b>10</b>
	Mitrovicë	63	63	1	0	0	0	0	<b>127</b>
	Pejë	1	0	2	0	0	0	1	<b>4</b>
	Prishtinë	2	3	0	1	0	0	0	<b>6</b>
	Prizren	3	0	3	0	0	0	1	<b>7</b>

11 SHËNIM: Të dhënat janë paraqitur me numra për shkak të numrit të vogël të të anketuarve që kanë deklaruar se kanë pasur nevojë për përkthim.








Të dhënat tregojnë që stafi i gjykatave e mirëkupton prezencën e palëve, prandaj kjo nuk është sfidë e madhe, duke qenë se personat që hyjnë nëpër gjykatore përshëndeteshin nga stafi i gjykatës në 93% të raste, ndërsa vetëm një përqindje e vogël nuk i përshëndesnin palët (7%). Në këtë pikë, dy gjykata morën 100% të pikëve, përkatësisht gjykatat e Pejës dhe Feizajt, që do të thotë se nuk pati asnjë rast të vetëm kur personat që hynë në gjykatore nuk u përshëndetën nga stafi i gjykatës.

■ **TABELA 61. Njerëzit që hynin në gjykatore përshëndeteshin nga stafi i gjykatës**

	Po	Jo
 Ferizaj	100.00%	0.00%
 Gjakovë	98.68%	1.32%
 Gjilan	96.83%	3.17%
 Mitrovicë	80.39%	19.61%
 Pejë	100.00%	0.00%
 Prishtinë	83.95%	16.05%
 Prizren	95.16%	4.84%








Nuk ka rregulla të shkruara që parashohin se gjykatësit duhet t'i vendosin emrat e tyre në tavolinën e trupit gjykues, megjithatë është shumë e rëndësishme që gjykatësit të prezantohen para fillimit të çdo seance. Megjithatë, ne kemi parë nëse kjo bëhet vullnetarisht nga gjykatësit. Rezultatet e monitorimit kanë treguar që në 69.39 % nga 100% të seancave gjyqësore të monitoruara, emrat e gjykatësve nuk kanë qenë të vendosur në një vend të dukshëm në tavolinën e trupit gjykues. Në anën tjetër, në rreth 30% të seancave gjyqësore të vëzhguara, emrat e gjykatësve kanë qenë të dukshëm në bankën e trupit gjykues, por këto janë raste kur kryesisht seancat janë mbajtur në zyrat e gjykatësve.

**TABELA 62. Emri i gjyqtarit/es ishte i dukshëm në bankën e trupit gjykues**

	Po	Jo
 Ferizaj	4.85%	95.15%
 Gjakovë	98.68%	1.32%
 Gjilan	0.00%	100.00%
 Mitrovicë	7.84%	92.16%
 Pejë	96.83%	3.17%
 Prishtinë	1.23%	98.77%
 Prizren	4.84%	95.16%








Edhe fillimi i seancave gjyqësore me kohë është vëzhguar. Rezultatet e monitorimit tregojnë që në 65.54% të rasteve, seancat kanë filluar me kohë, përderisa në 34.56% të rasteve kjo nuk ka ndodhur. Gjykata Themelore e Prishtinës ka numrin më të madh të rasteve ku seancat gjyqësore nuk filluar me kohë (61.73%), pastaj Gjilani (52.38%), dhe Mitrovica (42.16%), përderisa Gjykata Themelore e Prizrenit ka përqindjen më të vogël të rasteve të tilla (19.35%).

■ TABELA 63. Seanca dëgjimore ka filluar në kohë

	Po	Jo
 Ferizaj	59.22%	40.78%
 Gjakovë	89.47%	10.53%
 Gjilan	47.62%	52.38%
 Mitrovicë	57.84%	42.16%
 Pejë	85.71%	14.29%
 Prishtinë	38.27%	61.73%
 Prizren	80.65%	19.35%








Siç mund të shihet në tabelën më poshtë, në rast të vonesave, gjykatësit kanë kërkuar falje në fillim të seancës në 74% të rasteve të monitoruara. Në tri gjykata themelore (në Pejë, Gjakovë dhe Ferizaj) nuk ka pasur asnjë rast kur gjykatësit nuk kanë kërkuar falje në fillim të seancës në rast të vonesave. Në anën tjetër, rezultatet e vëzhgimit paraqesin një gjendje tjetër në gjykatat në Mitrovicë, Prishtinë, Prizren dhe Gjilan. Në rastin e Mitrovicës, në shumicën e rasteve të vëzhguara (65.12%), gjykatësit nuk kanë kërkuar falje për vonesa, pastaj në Prishtinë (52%), Prizren (33.33 %) dhe Gjilan (33.3 %).

**TABELA 64. Në rast vonese, gjyqtari/ja kërkoj falje për vonesën në fillimin e seancës dëgjimore**

	Po	Jo
 Ferizaj	100.00%	0.00%
 Gjakovë	100.00%	0.00%
 Gjilan	69.70%	30.30%
 Mitrovicë	34.88%	65.12%
 Pejë	100.00%	0.00%
 Prishtinë	48.00%	52.00%
 Prizren	66.67%	33.33%

Tutje, rezultatet e monitorimit tregojnë që gjykatësit janë prezentuar me emër në 80% të rasteve, përderisa në 20% të rasteve të monitoruara, kjo nuk kishte ndodhur. Gjakova prinë në këtë aspekt, duke qenë se në 100% të seancave të monitoruara gjykatësit janë prezentuar, ndjekur nga Ferizaj (99.03%), Gjilani (77.78%), Prizreni (77.42%), Mitrovica (76.47%), Peja (73.02%), dhe Prishtina (60.49%). Në anën tjetër, Prishtina ka përqindjen më të lartë të përgjigjeve negative sipas rasteve të vëzhguara (39.51%).

■ TABELA 65. Gjyqtari/ja e prezentoj veten me emër.

	Po	Jo
 Ferizaj	99.03%	0.97%
 Gjakovë	100.00%	0.00%
 Gjilan	77.78%	22.22%
 Mitrovicë	76.47%	23.53%
 Pejë	73.02%	26.98%
 Prishtinë	60.49%	39.51%
 Prizren	77.42%	22.58%








Kjo pyetje ishte përcjellë edhe me një përgjigje tekstuale që u kërkonte vëzhguesve të D+ që ta shpjegonin tutje se çfarë ndodhte në rast kur gjykatësit nuk prezantonin veten. Siç mund të shihet në tabelën më poshtë, përgjigja më e shpeshtë ishte se seanca fillonte menjëherë, pa ndonjë prezantim të gjykatësve.

Numri i arsyeve	Arsyet
53	Seanca gjyqësore fillonte menjëherë.
16	Nuk ishte seanca e parë.
10	Ishte i/e njëjti/a gjykatës/e e gjykimit, prandaj seanca fillonte duke konstatuar këtë fakt.

■ **TABELA 66.** Komentet e mbledhura nga të gjitha gjykatat themelore me fillimin e seancës gjyqësore.








Siç mund të vërehet edhe në tabelën e mëposhtme, shpjegimi i rregullave dhe mirësjelljes në fillim të seancave gjyqësore, nuk ishte sfidë për drejtësinë procedurale, duke qenë se në 96.9% të rasteve, kjo gjë ishte bërë nga gjykatësit dhe stafi i gjykatës.

■ **TABELA 67.** Gjyqtari/ja ose stafi mbështetës i gjykatës shpjeguan qartë Kodin e Etikës dhe rregullat përkatëse me rastin e fillimit të seancës gjyqësore.

	Po	Jo
 Ferizaj	100.00%	0.00%
 Gjakovë	100.00%	0.00%
 Gjilan	100.00%	0.00%
 Mitrovicë	100.00%	0.00%
 Pejë	98.41%	1.59%
 Prishtinë	86.42%	13.58%
 Prizren	93.55%	6.45%

Rezultatet e monitorimit tregojnë që në 95% të rasteve, gjykatësit kanë bërë një përshkrim të seancës dhe procesit gjyqësor në përgjithësi.

■ **TABELA 68. Gjyqtari/ja paraqiti një pasqyrë të përgjithshme të seancës gjyqësore dhe procesit gjyqësor në përgjithësi**

	Po	Jo
 Ferizaj	87.38%	12.62%
 Gjakovë	98.68%	1.32%
 Gjilan	98.41%	1.59%
 Mitrovicë	100.00%	0.00%
 Pejë	100.00%	0.00%
 Prishtinë	91.36%	8.64%
 Prizren	90.32%	9.68%








Në 5% të rasteve kur kjo përmbledhje e ecurisë së procesit gjyqësor nuk ishte bërë, anketuesit e D+ vëzhguan seancën më gjatë për të parë se si do të procedojë, ndërsa tabela më poshtë tregon se nuk kishte një trend të qartë se pse po ndodhte një gjë e tillë.

Numri i arsyeve	Arsyet
7	Palët refuzuan pasi që deklaruan se ata e dinë arsyen pse janë në seancë.
1	Vazhdoi me deklaratat e avokatëve.
1	Vazhdoi me dëgjimin e dëshmitarëve.
1	Lexoi aktgjykimin.
1	Filloi me pyetje për palët.
1	Filloi me leximin e akuzave ndaj të pandehurve.

■ TABELA 69. Komentet e bëra nga vëzhguesit e D+ nëpër të gjitha gjykatat e vëzhguara.








Rezultatet e monitorimit tregojnë që në 95% të rasteve, gjyqtarët kanë mbajtur kontakt me sy me palët gjatë seancës gjyqësore, ndërsa në 5% të rasteve, kjo nuk kishte ndodhur. Përçindja e fundit është dukshëm më e vogël dhe hyn brenda margjinave të gabimit.

■ **TABELA 70.** Gjyqtari/ja zhvilloi kontakt vizual me të gjitha palët e përfshira në këtë seancë gjyqësore

	Po	Jo
 Ferizaj	97.09%	2.91%
 Gjakovë	100.00%	0.00%
 Gjilan	100.00%	0.00%
 Mitrovicë	84.31%	15.69%
 Pejë	98.41%	1.59%
 Prishtinë	92.59%	7.41%
 Prizren	96.77%	3.23%








Për më shumë, u monitorua edhe paraqitja profesionale e gjykatësve, nëse kanë folur qartë dhe qetë. Rezultatet e monitorimit tregojnë që të folurit në mënyrë profesionale dhe të qetë nuk është problem që vërehet në shtatë gjykatat themelore. Siç shihet edhe në tabelën më poshtë, në 99.2% të rasteve, gjykatësit patën paraqitje profesionale duke folur në mënyrë të qartë dhe të qetë. Ishin vetëm tri raste të vëzhguara, përkatsisht në gjykatat e Mitrovicës dhe Prizrenit kur gjykatësit nuk folën qartë.

**TABELA 71. Gjyqtari/ja kishte paraqitje profesionale, duke folur në mënyrë të qartë dhe të qetë**

	Po	Jo
 Ferizaj	100.00%	0.00%
 Gjakovë	100.00%	0.00%
 Gjilan	100.00%	0.00%
 Mitrovicë	98.04%	1.96%
 Pejë	100.00%	0.00%
 Prishtinë	100.00%	0.00%
 Prizren	96.77%	3.23%








Një aspekt tjetër i rëndësishëm që është monitoruar ka të bëjë me mënyrën e referimit të gjykatësve ndaj palëve, përkatësisht nëse ata u drejtohen në emër. Tabela më poshtë tregon që në 85.6% të rasteve, gjykatësit iu referuan palëve në emër, ndërsa në 14% kjo nuk kishte ndodhur. Gjykata Themelore e Ferizajt është një përjashtim në këtë aspekt, duke qenë se në 79.61% të seancave të monitoruara, gjykatësit nuk ju ishin drejtuar në emër palëve, e që tregon një problem të konsiderueshëm të kësaj gjykate. Në rastet kur gjykatësit nuk iu referoheshin palëve me emër, u drejtohen vetëm si palë, të pandehur, të akuzuar (97 raste të vëzhguara) dhe si zotëri / zonjë (2 raste të vëzhguara).

**TABELA 72. Gjyqtari/ja ju referua palëve me emër**

	Po	Jo
 <b>Ferizaj</b>	20.39%	79.61%
 <b>Gjakovë</b>	100.00%	0.00%
 <b>Gjilan</b>	100.00%	0.00%
 <b>Mitrovicë</b>	95.10%	4.90%
 <b>Pejë</b>	98.41%	1.59%
 <b>Prishtinë</b>	93.83%	6.17%
 <b>Prizren</b>	91.94%	8.06%








Të dhënat tregojnë që në 98.8% të seancave të monitoruara, gjykatësit janë siguruar që palët i kanë kuptuar të drejtat e tyre, ndërsa në më pak se 2% kjo nuk ka ndodhur, gjë që e bënë këtë rezultat të papërfillshëm dhe brenda margjinave të gabimit.

■ TABELA 73. Gjyqtari/ja u siguria që palët i kanë kuptuar të drejtat e tyre

	Po	Jo
 Ferizaj	100.00%	0.00%
 Gjakovë	100.00%	0.00%
 Gjilan	100.00%	0.00%
 Mitrovicë	99.02%	0.98%
 Pejë	100.00%	0.00%
 Prishtinë	97.53%	2.47%
 Prizren	95.16%	4.84%








Më tutje, të gjitha palët që kanë folur, duke përfshirë gjykatësit, avokatët dhe palët janë dëgjuar mirë në 94% të seancave të vëzhguara. Gjykata që prinë në këtë aspekt është ajo e Gjakovës (100%) dhe Prizrenit (100%), pastaj ajo e Pejës (98.41%), Prishtina (97.53%), Gjilani (96.83%), dhe Mitrovica (92.16%). Në anën tjetër, përqindja më e lartë e folësve që nuk janë dëgjuar i përket Gjykatës Themelore të Ferizajt (23.3%).

■ **TABELA 74. Të gjithë folësit – gjyqtarët, avokatët dhe palët tjera, ka qenë e lehtë për t'i dëgjuar**

	Po	Jo
 <b>Ferizaj</b>	76.70%	23.30%
 <b>Gjakovë</b>	100.00%	0.00%
 <b>Gjilan</b>	96.83%	3.17%
 <b>Mitrovicë</b>	92.16%	7.84%
 <b>Pejë</b>	98.41%	1.59%
 <b>Prishtinë</b>	97.53%	2.47%
 <b>Prizren</b>	100.00%	0.00%








Në 99% të seancave të vëzhguara, gjyqtarët u kanë shpjeguar qartë palëve që duhet t'u përmbahen rregullave të gjykatës, urdhëresave të përkohshme dhe/apo vendimeve. Ky aspekt ka marrë përqindjen më të lartë të përgjigjeve pozitive në mesin e të gjitha pyetjeve të parashtruara.

■ **TABELA 75.** Gjyqtari/ja shpjegoi qartë se çfarë pritet nga palët që bëjnë në mënyrë që të jenë në linjë me pritshmëritë e gjykatës, rregulloret e brendshme dhe/ose vendimet

	Po	Jo
 Ferizaj	100.00%	0.00%
 Gjakovë	100.00%	0.00%
 Gjilan	100.00%	0.00%
 Mitrovicë	100.00%	0.00%
 Pejë	100.00%	0.00%
 Prishtinë	98.77%	1.23%
 Prizren	95.16%	4.84%

Po ashtu është shtuar edhe aspekti nëse palëve u është mundësuar parashtrimi i pyetjeve apo bërja e komenteve dhe rezultatet e monitorimit kanë treguar që në 97.3% të seancave, palëve u është lejuar parashtrimi i pyetjeve apo komenteve ndërsa nuk janë lejuar në vetëm 18% që do të thotë se nuk ka pasur asnjë rast kur palët nuk janë lejuar të bëjnë pyetje apo komente.








■ **TABELA 76. Palëve u është lejuar të bëjnë pyetje ose të japin komente**

	Po	Jo
 <b>Ferizaj</b>	91.26%	8.74%
 <b>Gjakovë</b>	100.00%	0.00%
 <b>Gjilan</b>	100.00%	0.00%
 <b>Mitrovicë</b>	99.02%	0.98%
 <b>Pejë</b>	100.00%	0.00%
 <b>Prishtinë</b>	92.59%	7.41%
 <b>Prizren</b>	98.39%	1.61%

Tutje, në 91.28% të seancave të monitoruara, gjykatësit i kanë kërkuar palëve që të përsërisin se si e kanë kuptuar rolin e tyre, veprimet / hapat e ndërmarrë, duke përfshirë gjobat që do të duhej të paguanin, dokumentet e dhëna etj. Në anën tjetër, pjesa më e madhe e seancave ku gjykatësit nuk i kanë kërkuar palëve që të përsërisin se çka kërkohet nga ta ishte në Ferizaj (55.34%), pastaj në Prizren (3.23%) dhe Prishtinë (2.47%), ndërsa situata të tilla nuk ishin vërejtur në gjykatat e tjera.








Arsyet e vëzhguara të rasteve kur gjykatësit nuk kanë kërkuar nga palët që ta përsërisin nëse e kanë kuptuar qartë se si duhet të veprojnë ishin a) nuk ka qenë përfundimi i rastit, b) rasti do të vazhdoj, dhe c) është vetëm fillimi i rastit gjyqësor (në 57 të rasteve të vëzhguara).

**TABELA 77. Gjyqtari/ja kërkoi nga palët që të përsërisin rolin e tyre, veprimet që duhen ndërmarrë/hapat e ardhshëm, duke përfshirë tarifat që duhen paguar, dokumentet që duhen paraqitur etj.**

	Po	Jo
 Ferizaj	44.66%	55.34%
 Gjakovë	100.00%	0.00%
 Gjilan	100.00%	0.00%
 Mitrovicë	100.00%	0.00%
 Pejë	100.00%	0.00%
 Prishtinë	97.53%	2.47%
 Prizren	96.77%	3.23%








Për më shumë, të dhënat tregojnë që në 99% të seancave të monitoruara, gjykatësit kanë përdorur terminologji gjuhësore të thjeshtë dhe të qartë.

■ **TABELA 78. Gjyqtari/ja përdori gjuhë të thjeshtë për t'i shpjeguar termet ligjore apo akronimet**

	Po	Jo
 Ferizaj	100.00%	0.00%
 Gjakovë	100.00%	0.00%
 Gjilan	100.00%	0.00%
 Mitrovicë	98.04%	1.96%
 Pejë	100.00%	0.00%
 Prishtinë	96.30%	3.70%
 Prizren	100.00%	0.00%








Rezultatet e monitorimit tregojnë që në 76% të seancave të monitoruara, palët janë konsultuar rreth datës së ardhshme të seancës, ndërsa në 25% të rasteve nuk ishin konsultuar fare. Gjykata që prinë me vëzhgim negativ është Mitrovica, (53.92%), pastaj Prizreni (48.39%), dhe Ferizaj (47.57%).

■ TABELA 79. Palët janë konsultuar para vendosjes së datës për seancën e radhës

	Po	Jo
 Ferizaj	52.43%	47.57%
 Gjakovë	100.00%	0.00%
 Gjilan	100.00%	0.00%
 Mitrovicë	46.08%	53.92%
 Pejë	98.41%	1.59%
 Prishtinë	83.95%	16.05%
 Prizren	51.61%	48.39%

Siç mund të shihet në tabelën e mëposhtme, në shumicën e rasteve të vëzhguara, nuk ka pasur nevojë për përkthim (85% nga 100%). Megjithatë në momentin që gjykata u vu në dijeni për nevojë për përkthim para fillimit të seancës, në 97% të seancave të monitoruara, kjo u bë në kohën e duhur (93 nga 95 rastet kur kjo ishte e nevojshme).

■ **TABELA 80. Gjykata ishte njoftuar paraprakisht për nevojën për përkthim, dhe është ofruar përkthimi me kohë.**  
(rretho këtu nëse nuk ka pasur nevojë për përkthim)

	Po	Jo	Totali
 Ferizaj	0.97%	0.00%	99.03%
 Gjakovë	1.32%	0.00%	98.68%
 Gjilan	7.94%	1.59%	90.47%
 Mitrovicë	69.61%	0.00%	30.39%
 Pejë	9.52%	1.59%	88.89%
 Prishtinë	6.17%	0.00%	93.83%
 Prizren	6.45%	0.00%	93.55%















## Renditja e gjykatave themelore bazuar në rezultatet e pyetjeve të observimit të punës në gjykatë

Të gjitha gjykatat themelore janë renditur në nivelin nga një deri në shtatë, ku një do të thotë që një gjykatë qëndron krahasimisht më mirë se të tjerat, ndërsa shtatë do të thotë se një gjykatë qëndron krahasimisht më dobët se gjykatat e tjera. Pikët për secilën gjykatë janë kalkuluar duke marrë për bazë mesataren e pikëve të dala nga numri i përgjigjeve pozitive dhe negative që kanë dhënë të anketuarit në listën prej 18 pyetjeve të parashtruara, duke përfshirë:

- 1) Njerëzit që po hynin në gjykatore janë përshëndetur nga stafi i gjykatës;
- 2) Emri i gjyqtarit/es ishte i dukshëm nga banka e trupit gjykues;
- 3) Seanca dëgjimore filloi në kohë;
- 4) Gjyqtari/ja e prezantoi veten me emër;
- 5) Në rast vonese, gjyqtari/ja kërkoi falje për vonesën në fillim të seancës gjyqësore;
- 6) Gjyqtari/ja ose stafi mbështetës i gjykatës shpjeguan qartë Kodin e Etikës dhe rregullat me rastin e fillimit të seancës gjyqësore;
- 7) Gjyqtari/ja paraqiti një pasqyrë të përgjithshme të procesit të seancës gjyqësore, si për rastin e seancës në fjalë, ashtu edhe për zhvillimin e përgjithshëm të rastit;
- 8) Gjyqtari/ja zhvilloi kontakt vizual me të gjitha palët e përfshira në këtë seancë gjyqësore;
- 9) Gjyqtari/ja kishte paraqitje profesionale, duke folur në mënyrë të qartë dhe të qetë;
- 10) Gjyqtari/ja iu referua palëve me emër;
- 11) Gjyqtari/ja u siguroi që palët i kanë kuptuar të drejtat e tyre;
- 12) Të gjithë folësit – gjyqtarët, avokatët dhe palët, ishte e lehtë për t'i dëgjuar;
- 13) Gjyqtari/ja shpjegoi qartë çfarë pritet prej palëve që të jenë në linjë me pritshmëritë e gjykatës, rregulloret e brendshme;
- 14) Palëve iu është lejuar të bëjnë pyetje ose të japin komente;
- 15) Gjyqtari/ja kërkoi nga palët që të përsërisin veprimet që duhen ndërmarrë/hapat e ardhshëm, duke përfshirë tarifatat që duhen paguar, dokumentet që duhen paraqitur etj;
- 16) Gjyqtari/ja përdori gjuhë të thjeshtë për të shpjeguar terminologjinë ligjore apo akronimet;
- 17) Palët janë konsultuar para vendosjes së datës për seancën e radhës;
- 18) Gjykata ishte njoftuar paraprakisht për nevojën për përkthim, dhe i njëjti shërbim është ofruar me kohë.

**Renditja e gjykatave themelore bazuar në rezultatet e pyetjeve të observimit të punës në gjykatë**

**Gjykatat Themelore**

	<b>Vendi i parë</b>		Gjakovë
	<b>Vendi i dytë</b>		Pejë
	<b>Vendi i tretë</b>		Gjilan
	<b>Vendi i katërt</b>		Mitrovicë
	<b>Vendi i pestë</b>		Prizren
	<b>Vendi i gjashtë</b>		Prishtinë
	<b>Vendi i shtatë</b>		Ferizaj

# Rekomandime të politikave

Bazuar në dy anketat e realizuara dhe me qëllim të përmirësimit të zbatimit të drejtësisë procedurale në të shtatë gjykatat themelore të Kosovës, D+ ka përpiluar rekomandimet e politikave të listuara si në vijim:

- Gjykatat themelore duhet të promovojnë përdorimin e ueb-faqeve të gjykatave përmes kanaleve të ndryshme, duke përfshirë mediat sociale, kodet dhe/ose broshurat. Këto të fundit do të mund të shpërndaheshin në hyrje të gjykatave apo në këndet e informimit, përderisa kodet do të mund të vendoseshin në hyrje dhe/apo në ndërtesë të gjykatave e që do t'u mundësonin përdoruesve të shërbimeve të gjykatave që të skanojnë këto kode përmes telefonave mobil dhe të lidhen me ueb-faqen e gjykatës menjëherë.
- Gjykata themelore duhet t'i informojnë qytetarët në mënyrë sistematike për ekzistimin e kutive të ankesave dhe mundësinë e parashtrimit të ankesave, dhe të sigurohen që ankesat do të shqyrtohen. Shenjat mund të vendosen në hyrje apo në korridoret e ndërtesave të gjykatës
- Gjykatat themelore duhet të vendosin shenja / apo t'i vendosin këndet e informimit në pozicione më të mira brenda ndërtesave të gjykatave, sidomos në Gjykatën Themelore të Gjilanit, ku 60.97% e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave kanë deklaruar se nuk kanë njohuri se këto kënde ekzistojnë.
- I gjithë stafi i gjykatave duhet të trajnohen sistematikisht se si t'i trajtojnë përdoruesit e shërbimeve të gjykatave me mirësjellje dhe respekt.
- Të gjithë gjykatësit/et duhet të trajnohen sistematikisht në trajtimin e paanshëm të përdoruesve të shërbimeve të gjykatave.
- Duhet të prioritetizohet përmirësimi i komunikimit në gjuhë amtare për përdoruesit e shërbimeve të gjykatave në Gjykatën Themelore të Mitrovicës dhe atë të Gjakovës.
- Të gjithë përdoruesit e shërbimeve të gjykatave duhet të njoftohen për mundësinë e parashtrimit të ankesave për shkelje disiplinore të gjykatësve në këndin e informacionit të gjykatës, por edhe përmes broshurave që mund të shpërndahen në hyrje të gjykatës dhe brenda ndërtesës. Për më shumë, ky informacion duhet të vendoset edhe në ueb-faqen e secilës gjykatë themelore.
- Vendosja e emrave të gjykatësve duhet të adresohet përmes një rregulloreje të brendshme që i obligon gjykatësit të vendosin emrat e tyre në bankën e trupit gjykues.
- Të gjithë gjykatësit duhet të trajnohen për rëndësinë e saktësisë së fillimit në kohë të seancave gjyqësore.

# SHTOJCA I

## 1. Regjioni

- Prishtina
- Mitrovica
- Peja
- Gjakova
- Gjilan
- Ferizaj
- Prizren

## 2. Gjinia e të anketuarit

- Mashkull
- Femër

## 3. Moshë e të anketuarit

- 15-17 vjeç
- 18-24 vjeç
- 25-34 vjeç
- 35-44 vjeç
- 45-54 vjeç
- 55-64 vjeç
- 65+ vjeç

## 4. Përkatësia kombëtare të anketuarit

- Shqiptar
- Serb
- Turk
- Boshnjak
- Rom
- Ashkali
- Egjiptas
- Goran
- Tjetër

## 5. Nëse keni selektuar tjetër, ju lutem specifikoni

---

**6. Pse keni ardhur sot në gjykatë?**

- Palë në procedurë – person fizik
- Avokat apo përfaqësues i autorizuar
- VETËM për shërbime administrative: dokumente, informata, pagesa, dhënia e deklaratës, etj.
- Dëshmitar
- Gazetar
- Vëzhgues/Përkrahje të një të afërmi apo miku
- Gjuqtar, Bashkëpunëtor Profesional
- Prokuror, Bashkëpunëtor Profesional
- Personel administrativ
- Punoj në gjykatë, por jo në detyrë profesionale
- Tjetër

**7. Nëse keni selektuar tjetër, ju lutem specifikoni**

---

**8. Në çfarë roli jeni sot në gjykatë?**

- Paditës
- I pandehur
- Viktimë
- I paditur

**9. Çfarë lloj lënde ju ka sjellë në gjykatë?**

- Penale
- Civile
- Ekonomike
- Administrative
- Kundërvajtje
- Me të mitur

**10. Sipas përvojës suaj, sa është e lehtë që të merrni informata nga gjykata për lëndën tuaj?**

- Tejet e vështirë
- Deri diku e vështirë
- Deri diku e lehtë
- Tejet e lehtë

**11. Sa ishin të dobishme informatat që u janë dhanë nga gjykata?**

- Tejet të padobishme
- Deri diku të padobishme
- Deri diku të dobishme
- Tejet të dobishme

**12. A ishte e lehtë të gjeni gjykatoren apo zyrën që ju duhej?**

- Tejet e vështirë
- Deri diku e vështirë
- Deri diku e lehtë
- Tejet e lehtë

**13. Çka do të ndihmonte në këtë aspekt?**

---

**14. A ka gjykata kuti të ankesave?**

- Po
- Jo
- Nuk e di

**15. A ka gjykata kënd informativ?**

- Po
- Jo
- Nuk e di

**16. A e përdorni faqen e internetit të gjykatës si burim informacioni?**

- Po
- Jo

**17. Çfarë informacioni kërkonte zakonisht në faqen e internetit të gjykatës?**

- Orarin e seancave
- Kontakte
- Lajme
- Vendime të publikuara
- Informata për gjyqtarët
- Tjetër

**18. Nëse keni selektuar tjetër, ju lutem specifikoni**

---

**19. A është përmbajtja e faqes së internetit në gjuhën tuaj amtare?**

- Po
- Jo

**20. A jeni të kënaqur me kualitetin e përkthimit të përmbajtjes së faqes së internetit?**

- Po
- Jo

**21. A keni kryer punë në gjykatë brenda një kohe të arsyeshme sot?**

- Po
- Jo

**22. Qe sa kohë është e hapur lënda juaj?**

- Më pak se gjashtë muaj
- Gati 1 vit
- Gati 2 vite
- Gati 3 vite
- Gati 5 vite
- Më shumë se 5 vite
- Më shumë se 10 vite

**23. A jeni të kënaqur me kohën që po merr shqyrtimi i lëndës tuaj?**

- Tejet i pakënaqur
- Deri diku i pakënaqur
- Deri diku i kënaqur
- Tejet i kënaqur

**24. A jeni trajtuar me mirësjellje dhe respekt nga personeli i gjykatës?**

- Po
- Jo
- Deri diku

**25. A vlerësoni që jeni trajtuar fer nga gjyqtari?**

- Po
- Jo
- Deri diku

**26. A ju është dhënë mundësia që të flisni në gjuhën tuaj amtare me personelin e gjykatës?**

- Po
- Jo

**27. A ka ofruar gjykata përkthim gjatë seancave?**

- Po
- Jo
- N/A

**28. A jeni të kënaqur me kualitetin e përkthimit gjatë seanceve?**

- Tejet i pakënaqur
- Deri diku i pakënaqur
- Deri diku i kënaqur
- Tejet i kënaqur

**29. A i pranoni/merrni dokumentet nga gjykata në gjuhën tuaj amëtare?**

- Po
- Jo
- Ndonjëherë

**30. A ndjeheni (fizikisht) të sigurtë në objektin e gjykatës?**

- Po
- Jo

**31. Nëse jo, pse nuk ndjeheni të sigurtë?**

---

**32. A jeni të informuar se mund të ankoheni për shkelje disiplinore të gjyqtarit?**

- Po
- Jo

**33. Nëse po, a e dini se ku mund të ankoheni?**

- Po
- Jo

**34. A ju është kërkuar ndonjëherë ryshfet/mito nga ndonjë gjyqtar ose punonjës i gjykatës ose ndonjë ndërmjetësues në emër të tyre?**

- Po
- Jo

**35. Nëse po, për çfarë arsye?**

- Për t'i përshpejtuar proceset
- Për të marrë dokumentacionin e nevojshëm
- Që lënda të vendoset në favor timin
- Tjetër

**36. Nëse keni selektuar tjetër, ju lutem specifikoni**

---

**37. A i keni ofruar ndonjëherë ryshfet një gjyqtari ose punonjësi tjetër të gjykatës?**

- Po
- Jo

**38. Nëse po, për çfarë arsye?**

- Për t'i përshpejtuar proceset
- Për të marrë dokumentacionin e nevojshëm
- Që lënda të vendoset në favor timin
- Tjetër

**39. Nëse keni selektuar tjetër, ju lutem specifikoni**

---

**40. Nëse po, çfarë posti mban personi?**

- Gjyqtar
- Punonjës i gjykatës
- Tjetër

**41. Nëse keni selektuar tjetër, ju lutem specifikoni**

---

**42. Në cilën pjesë të ndërtesës së gjykatës keni shkuar?**

- Gjykatore
- Zyrat e gjyqtarëve
- Zyra e administratorit të gjykatës
- Zyra për menaxhimin e lëndëve
- Arkatari / zyra e financave
- Tjetër

**43. Nëse keni selektuar tjetër, ju lutem specifikoni**

---

**44. A do të ndiheshit rehat t'i shkruanit ankesat tuaja për gjykatën dhe të njëjtat t'i vendosnit në kutinë e ankesave?**

- Po
- Jo

**45. A keni biseduar me dikë tek këndi i informimit?**

- Po
- Jo

**46. Sa ju ka ndihmuar personi përgjegjës në këndin e informimit?**

- Më ka ndihmuar shumë
- Më ka ndihmuar deri diku
- Nuk më ka ndihmuar shumë
- Nuk më ka ndihmuar aspak

**47. Kishte mjaftueshëm shenja dhe informata për të kuptuar procedurat e sigurisë për të hyrë në ndërtesë**

- Pajtohem plotësisht
- Pajtohem
- Nuk pajtohem
- Nuk pajtohem aspak

**48. Personeli i sigurimit ishin të dobishëm dhe të respektueshëm**

- Pajtohem plotësisht
- Pajtohem
- Nuk pajtohem
- Nuk pajtohem aspak

**49. Ndërtesa ishte e pastër dhe e mirëmbajtur**

- Pajtohem plotësisht
- Pajtohem
- Nuk pajtohem
- Nuk pajtohem aspak

**50. Shenjat e vendosura përreth ndërtesës dhe brenda gjykatores ishin të dukshme dhe lehtësisht të kuptueshme**

- Pajtohem plotësisht
- Pajtohem
- Nuk pajtohem
- Nuk pajtohem aspak

**51. Shenjat e vendosura përreth ndërtesës dhe brenda gjykatores ishin në gjuhën time amëtare**

- Po
- Jo

**52. Që kur ka filluar të shqyrtohet lënda juaj, a ka ndodhur ndonjëra nga të mëposhtmet**

- Kam munguar në punë për të marrë pjesë në një seancë gjyqësore ose për të kryer punë në gjykatë
- Kam ardhur në gjykatë dhe jam ndjerë sikur nuk ka pasur asnjë përparim me lëndën time.
- Ka ndikuar në aftësinë time për të gjetur punë/për t'u licencuar/për t'u certifikuar
- Më është pamundësuar aplikimi për vizë
- Më është dashur të ndërroj avokatin/përfaqësuesin ligjor
- Nuk kam pasur avokat dhe më është dashur ta përfaqësoj veten.

**53. Nëse ju është dashur të riktheheni për një seancë tjetër gjyqësore, a ju ka pyetur ndokush se çfarë date do të ishte më e përshtatshme për ju?**

- Po
- Jo
- Nuk duhet të kthehem në gjykatë

**54. Nëse jeni trajtuar ndryshe prej palëve të tjera, pse mendoni se jeni trajtuar ndryshe?**

- Raca/Etnia ime  Gjuha që unë flas  Gjinia ime
- Statusi im ekonomik
- Pamja ime (veshja, flokët, etj.)  Moshë ime
- Tjetër

**55. Nëse keni selektuar tjetër, ju lutem specifikoni**

---

**56. Në përgjithësi, a mendoni se keni patur mundësinë t'i parashtroni pyetjet, përgjigjet e të cilave ju nevojiteshin sot?**

- Po
- Jo
- N/A

**57. A keni ndonjë gjë për të shtuar?**

---

# SHTOJCA II

## Formulari i vëzhgimit të përvojës në gjykatore

Gjykata:

Data:

Vëzhguesi:

<b>Docket#:</b>	
<b>Salla#:</b>	<b>Koha e fillimit të vëzhgimit:</b> <b>Koha e përfundimit të vëzhgimit:</b>
<b>Gjyqtari</b>	<input type="checkbox"/> M <input type="checkbox"/> F <input type="checkbox"/> Shq <input type="checkbox"/> Ser <input type="checkbox"/> Bos <input type="checkbox"/> Tur <input type="checkbox"/> Rom <input type="checkbox"/> Ash <input type="checkbox"/> Egj <input type="checkbox"/> Gor/tjetër
<b>Akuzuesi 1</b>	<input type="checkbox"/> M <input type="checkbox"/> F <input type="checkbox"/> Shq <input type="checkbox"/> Ser <input type="checkbox"/> Bos <input type="checkbox"/> Tur <input type="checkbox"/> Rom <input type="checkbox"/> Ash <input type="checkbox"/> Egj <input type="checkbox"/> Gor/tjetër
<b>Akuzuesi 2</b>	<input type="checkbox"/> M <input type="checkbox"/> F <input type="checkbox"/> Shq <input type="checkbox"/> Ser <input type="checkbox"/> Bos <input type="checkbox"/> Tur <input type="checkbox"/> Rom <input type="checkbox"/> Ash <input type="checkbox"/> Egj <input type="checkbox"/> Gor/tjetër
<b>Akuzuesi 3</b>	<input type="checkbox"/> M <input type="checkbox"/> F <input type="checkbox"/> Shq <input type="checkbox"/> Ser <input type="checkbox"/> Bos <input type="checkbox"/> Tur <input type="checkbox"/> Rom <input type="checkbox"/> Ash <input type="checkbox"/> Egj <input type="checkbox"/> Gor/tjetër
<b>I pandehuri/ Respondenti 1</b>	<input type="checkbox"/> M <input type="checkbox"/> F <input type="checkbox"/> Shq <input type="checkbox"/> Ser <input type="checkbox"/> Bos <input type="checkbox"/> Tur <input type="checkbox"/> Rom <input type="checkbox"/> Ash <input type="checkbox"/> Egj <input type="checkbox"/> Gor/tjetër
<b>I pandehuri/ Respondenti 2</b>	<input type="checkbox"/> M <input type="checkbox"/> F <input type="checkbox"/> Shq <input type="checkbox"/> Ser <input type="checkbox"/> Bos <input type="checkbox"/> Tur <input type="checkbox"/> Rom <input type="checkbox"/> Ash <input type="checkbox"/> Egj <input type="checkbox"/> Gor/tjetër
<b>I pandehuri/ Respondenti 3</b>	<input type="checkbox"/> M <input type="checkbox"/> F <input type="checkbox"/> Shq <input type="checkbox"/> Ser <input type="checkbox"/> Bos <input type="checkbox"/> Tur <input type="checkbox"/> Rom <input type="checkbox"/> Ash <input type="checkbox"/> Egj <input type="checkbox"/> Gor/tjetër
<b>Përkthimi i siguruar (shënoni të gjitha):</b>	<input type="checkbox"/> Shq <input type="checkbox"/> Ser <input type="checkbox"/> Bos <input type="checkbox"/> Tur <input type="checkbox"/> Rom <input type="checkbox"/> Tjetër

## Pyetjet e vëzhgimit

- 
- Po**  **Jo**     1. Njerëzit që po hynin në gjykatore janë përshëndetur nga stafi i gjykatës.
- 
- Po**  **Jo**     2. Emri i gjyqtarit/es ishte i dukshëm nga banka e trupit gjykues.
- 
- Po**  **Jo**     3. Seanca dëgjimore filloi në kohë.
- 
- Po**  **Jo**     4. Gjyqtari/ja e preztoi veten me emër.
- 
- Po**  **Jo**     5. Në rast vonese, gjyqtari/ja kërkoi falje për vonesën në fillimin e seancës gjyqësore.
- 
- Po**  **Jo**     6. Gjyqtari/ja ose stafi mbështetës i gjykatës shpjeguan qartë kodin e etikës dhe rregullat me rastin e fillimit të seancës gjyqësore.
- 
- Po**  **Jo**     7. Gjyqtari/ja paraqiti një pasqyrë të përgjithshme të procesit të seancës dëgjimore, si për rastin e seancës në fjalë, ashtu edhe për zhvillimin e përgjithshëm të rastit.
- 
- Po**  **Jo**     8. Gjyqtari/ja zhvilloi kontakt vizual me të gjitha palët e përfshira në këtë seancë gjyqësore.
- 
- Po**  **Jo**     9. Gjyqtari/ja kishte paraqitje profesionale, duke folur në mënyrë të qartë dhe të qetë.
- 
- Po**  **Jo**     10. Gjyqtari/ja iu referua palëve me emër.
- 
- Po**  **Jo**     11. Gjyqtari/ja u siguroi që palët i kanë kuptuar të drejtat e tyre.  
Nëse jo, jepni më shumë detaje:
- 
- Po**  **Jo**     12. Të gjithë folësit – gjyqtarët, avokatët dhe palët, ishte e lehtë për t'i dëgjuar.
- 
- Po**  **Jo**     13. Gjyqtari/ja shpjegoi qartë çfarë palët duhet të bëjnë në mënyrë që të jenë në linjë me pritshmëritë e gjykatës, rregulloret e brendshme.
- 
- Po**  **Jo**     14. Palëve iu është lejuar të bëjnë pyetje ose të japin komente.
- 
- Po**  **Jo**     15. Gjyqtari/ja kërkoi nga palët që të përsërisin rolin e tyre, veprimet që duhen ndërmarrë/hapat e ardhshëm, duke përfshirë tarifat që duhen paguar, dokumentet që duhen paraqitur etj.
- 
- Po**  **Jo**     16. Gjyqtari/ja përdori gjuhë të thjeshtë për të shpjeguar terminologjinë ligjore apo akronimet.
- 
- Po**  **Jo**     17. Palët janë konsultuar para vendosjes së datës për seancën e radhës
- 
- Po**  **Jo**     18. Gjykata ishte e njoftuar paraprakisht për nevojën për përkthim, dhe e ka ofruar përkthimin me kohë. (rretho këtu nëse nuk ka pasur nevojë për përkthim)
-

